

Vladimir  
Mecaj

BIBLIOTEKA  
SHITETIT

I PANJOHURI

*i Rinastit*



*tregime*

01H-32

M 52


VLADIMIR MEÇAJ

# I PANJOHURI I RINASIT

Tregime



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»



## I PANJOHURI I RINASIT

Ishte viti 196...

Në bulevardin e madh po ecte një njeri. Në dorë mbante një çantë. Ecte i qetë dhe herë pas here përshëndeste kalimtarët. Ishte një burrë i gjatë e me fytyrë të hequr. Në kokë mbante një kasketë, ndërsa nën strehët e saj ndrisnin dy sy të zinj e të mëdhenj. Për një çast ndaloi para sahatit të madh të qytetit e ngriti kokën. Donte edhe pak që të fi-



llonte puna. U drejtua nga kafeneja. Ushtari që rrinte te dera, pasi e nderoi, i tha se e kishte kërkuar një burrë pak i vjetër në moshë.

— Po të vijë prapë i thuaj të më presë. Do të pi një kafe - iu përgjigj ushtarit dhe hyri në klub. Hodhi një sy nëpër sallë dhe u drejtua nga një tryezë bosh. «Kush të më ketë kërkuar?», tha me vete dhe u ul në kolltukun e butë.

— Shoku Artan, ju kërkojnë. — Ishte përsëri ushtari.

Jashtë pa një fytyrë të njohur. Diku e kishte takuar, po ku? U takua me të dhe të dy bashkë filluan të ecnin.

— Më thanë t'ju takoj juve — tha qytetari. — Quhem Tahir. Punoj në klubin e Rinasit.

— A po, po — Artani u kujtua se qytetari punonte në aeroportin e Rinasit dhe aty e kishte parë disa herë.

Artani e ftoi në zyrën e pritjes Tahirin dhe bisedoi me të rreth gjysmë ore. Pastaj Tahiri u largua. Artani e ndoqi me sy duke sjellë ndër mend ato çka ai denoncoi. Pastaj tha me vete: «Konstatim interesant».

## 1

— Alo...! Artani jam... Po... Po. Tani po ju pres...- Artani uli mikrotelefonin dhe u çua në këmbë. Nxori paketën dhe ndezi një cigare. Nga dritarja dukej rruga e gjerë e plot dritë. Ishte mbrëmje. Hapi dritaren. Ajri i pastër i rrahu fytyrën. Ishin ditët e para të nëntorit. Festat po afronin dhe atmosfera e tyre ndjehej kudo. Rrugët e ndri-



çuara e të zbukuruara mbartnin mbi shpatullat e tyre me mijëra lumturi. Sytë e Artanit shëtisnin midis grumbullit të njerëzve që kishin mbushur bulevardin. Midis tyre herë pas here dukeshin autobuzët e mëdhenj, që çanin midis njerëzve, të cilët lironin rrugën duke krijuar një korridor të gjërë. Autobuzët i afroreshin njëri-tjetrit dhe i binin borisë. Artanit kjo gjë i kujtonte lodrat e fëmijëve të cilët kënaqen dhe bërtasin kur arrijnë njëri-tjetrin me vrap. Kështu dhe autobuzët vazhdonin vrapin e tyre midis mijëra hapave të çrregullta, që godisnin tokën pa pushim. Artani shikonte bulevardin dhe një buzëqeshje e lehtë i loste në cepat e buzëve. Humbi i tëri duke parë ato që po ndodhnin në pak minuta në rrugë. E sollën në vete të trokiturat në derë.

— Hyrë, — tha dhe mbylli dritaren. Dera u hap dhe hyri një djalë i ri me një trup mesatar. Quhej Ergys. Para disa vjetësh kishte mbaruar fakultetin e gjuhëve të huaja dhe ishte caktuar për të punuar në organet e Sigurimit të Shtetit.

— Kemi një denoncim të tillë. — nisi bisedën Artani. Ergysi u ul. Artani nxori një fletë të bardhë dhe vazhdoi të fliste.

— Ditën e hënë, një veturë me targë diplomatike ka qëndruar në aeroportin e Rinasit. Me të ka udhëtuar Aleksei, funksionar i një ambasade të huaj. Bashkë me të ka qenë edhe shoferi i tij. Të dy bashkë kanë qëndruar për afro njëzet minuta në klubin e Rinasit. Aleksei gjithmonë, shikonte nga dritarja sikur priste dikë. Avioni akoma nuk kishte ardhur. Perdja prej tyli nuk e pengonte atë të shikonte përtej xhamit. Kur nga altoparlanti u lajmërua se së shpejti mbrinte avioni i linjës, ata të dy janë çuar nga vendi. Shoferi ka shkuar në banak për të pa-

guar, ndërsa Aleksei është drejtuar nga dera. Në hyrje të klubit diçka ka biseduar me një meso burrë. Ajo që të lë të dyshosh është se biseda ka qenë aq e shkurtër, sa është bërë kalimthi. Kjo ndodhi në pak sekonda. Pra një shkëmbim fjalësh të shkurtra, gati telegrafike. Pastaj Aleksei është takuar me një bashkatdhetar të tij, që erdhi me avion. Pastaj janë nisur në drejtim të Tiranës. Ai që është takuar me Aleksein është i panjohur. Dihen vetëm disa karakteristika të përgjithshme të fytyrës. Flokët i ka të verdhë e pak të rënë në ballë. Atë ditë kishte veshur një xhakavento sportive me ngjyrë të papërcaktuar mirë. Nga Rinasi është larguar me një motorr «Java» të cilin e ngjiste vetë, Pra vetëm kaq.

Ergysi e dëgjonte me vëmendje të madhe. Në mendjen e tij mundohej të rikujtonte tipin e panjohur. Ato pak gjëra që dëgjoi nuk e ndihmonin të krijonte një ide të saktë e të plotë për të panjohurin që ishte takuar me Aleksein. Këtë të fundit e njihte mirë. Pak i shëndoshë, i gjatë, me një fytyrë të rrumbullaktë, ku humbisnin dy sy të vegjël e dinakë. E kishte parë shpesh rrugës që të çon në liqenin artificial, jashtë qytetit. Zakonisht ai mbante një bastun në dorë, ndërsa në dimër vinte në kokë një kokore të zezë.

Artani pa e humbur fillin vazhdonte të fliste me një ton të qetë, ku spikaste siguria. Ergysi dhe për shumë probleme të tjera kishte pasur lidhje me Artanin dhe ia njihte mirë karakterin. Por më tepër, Ergysi e çmonte Artanin për gjakftohtësinë e tij, për analizën e thellë dhe për logjikën e fortë. Ai asnjëherë nuk nxitohej të jepte konkluzione të shpejtuara. Pasi grumbullonte fakte, i shoshiste



ato mirë e mirë, pastaj jepte variantet e mundshme.

Artani e mbylli bisedën me këto fjalë:

— Është e domosdoshme që të vërtetojmë nëse Aleksei merret me veprimtari spiunazhi kundër nesh. Deri tani nuk dimë asgjë për këtë njeri. Të mos harrojmë për asnjë çast situatën politike që po kalojmë...

## 2.

Kishin kaluar pesë ditë nga mbrëmja kur Ergysi bisedoi me Artanin. Po ato net të bukura vjeshte, po ajo gjallëri që marrin rrugët e njerëzit në raste festash. Për një njeri të zakonshëm ndofta ato ditë ishin të njëjlojta. Fillonin me një diell të lehtë, gati ledhatonjës, arrinin një mesditë të nxehtë dhe përsëri një diell i butë në të perënduar. Pastaj binte mbrëmja me një të ftohtë gati të pandjeshëm. Për Ergysin ato kishin pasur të rejat e tyre. Ai i mbante mend dhe orët e cdo dite, pasi në çdo orë që kalonte mësonte diçka. Mendja e tij deri tani kishte depërtuar në disa të fshehta. Për këto ai mendonte deri natën vonë. Mundohej të krijonte në mendjen e vet ato fije të padukshme që lidhnin Aleksein me tre miqtë e tij. Artani gjatë këtvre ditëve nuk kishte qenë aty. Ai diku kishte shkuar. Kishte thënë se do të vonohej vetëm disa ditë. Tre miqtë e Alekseit, shqiptarët, ai i njohu mirë. E vetmja gjë që e bënte të dyshonte Ergysin ishin takimet e tyre në vende me pak qarkullim. Dhe ja si kishte ndodhur.... Aleksei e pat bërë zakon të shetiste i vetmuar. Dilte nga ambasada duke goditur rrugët me bastunin që mbante në dorë dhe drejtohej nga par-

ku. Ecte i vetëm dhe shikonte peisazhin e bukur. Kujdo që do t'i binte rasti ta shikonte i krijonte përshtypjen se ishte një amator i shetitjeve në natyrë. Dukej sikur natyra dhe peisazhi e çlodhnin se tepërmi. Bastunin, edhe kur dilte në kodër, e përplaste në tokë. Shëtitjen e vazhdonte disa orë rresht. Ashtu i vetëm, midis parkut në periferi të qytetit, ai të krijonte përshtypjen se nuk priste dhe as që kishte ndërmend të takonte njeri. Lëvizjet e tij ishin pothuajse indiferente. Kalonte rrugë e pa rrugë. Kalimtarët e shikonin disi të çuditur, jo vetëm se ishte i huaj por edhe se mosha e tij e madhe sikur nuk shkonte në mes të të rinjve, në parkun e periferisë së qytetit. Atë ditë Aleksei, pasi kishte ecur gati dy orë në mënyrë krejt të natyrshme, shkoi e takoi një njeri. Aleksei të jepte përshtypjen e atij njeriu që është mërzhitur me vetëminë dhe ka dëshirë të madhe të flasë ose të takohet me dikë. Kështu veproi edhe me shtetasin shqiptar. U takua me të dhe, pasi bisedoi pak, u largua. Aleksei pas kësaj kishte vazhduar edhe pak shetitjen dhe ishte kthyer qetë-qetë në qytet. Këto shetitje Aleksei i kishte vazhduar edhe ditë të tjera. Në të njëjtën mënyrë ishte takuar edhe me dy shqiptarë të tjerë. Ergysi të tre këta shqiptarë që ishin takuar me Aleksein i njihte. Këta ishin Aliu, Stasi, dhe Naimi. Takimet e tyre me Aleksein të krijonin përshtypjen se ishin krejt të rastit dhe të papregatitura. Këtë mendim ia forconte edhe fakti që këto nuk u përsëritën më. Ndofta këtu nuk kishte asgjë për të dyshuar, por Ergysit nuk i hiqej nga mendja për asnjë çast ajo fije dyshimi që kishte zënë rrënjë thellë në mendjen e tij për vet faktin se Aliu, Stasi dhe Naimi ishin shokë midis tyre. Këta të tre kishin



mbaruar studimet në shtetin e Alekseit. Kjo ishte një pikë e përbashkët për të gjitha këto takime. Veç kësaj, dyshimin e Ergysit e përforconte edhe një takim që pat vënë re midis shoferit të Alekseit dhe njërit prej të tre shokëve dhe pikërisht me Aliun. Ky takim ishte kryer me kujdesin dhe fshehtësinë më të madhe. Shoferi ishte takuar disa herë me Aliun, në po këto rrethana. Në ditët e mëvonshme nuk u organizua asnjë takim i tillë. Çdo gjë ra në heshtje. Ergysin e shqetësonin shumë mendime: «Pse Aleksei i ndërpreu takimet me Aliun, Stasin dhe Naimin? Mos vallë takimet e tyre qenë krejt të rastit? Po mirë, shoferi i Alekseit, atëherë përse u takua me Aliun? Pastaj, përse shoferi takohet vetëm me Aliun? Jo, jo. Këto takime nuk kanë qenë të rastit. Këtu ka diçka të organizuar, të kamufluar me shumë zgjuarsi».

Me këto mendime në kokë Ergysi hyri në zyrën e Artanit. Atë e gjeti ulur në tryezë. Ergysi filloi t'i shpjegonte situatën Artanit, ndërsa ky, si gjithmonë, e dëgjonte duke goditur ritmikisht tryezën me një laps. Ndërsa Ergysi fliste, Artani ndërhyri papritur:

— Domethënë Stasi, Naimi dhe Aliu... madje ky i fundit edhe me shoferin e tij?

— Po, — u përgjigj Ergysi.

— Aleksei doli nga skena. Vendin e tij e zuri shoferi. E qartë. Ai për aq punë u duhej, — tha Artani. — Shoferi takohet vetëm me Aliun. Miqësia e Aliut me Stasin dhe Naimin vazhdon, por e fshehur. A nuk të duket, Ergys, se këto janë tri rrëkeza. Në një çast shkrihen në një, që është Aliu, dhe pikërisht këtu shkon e mbush ujë shoferi i Alekseit. Në qoftë se kemi një grup të organizuar,

mundet që Aliu të jetë përgjegjës i tyre dhe pikërisht me këtë shkon e takohet shoferi. Apo jo? Si mendon, Ergys? — Artani ngriti kokën dhe vështroi në sy Ergysin.

— Nikollain e njeh? — pyeti Artani.

Ergysit i erdhi e papritur kjo pyetje. Ç'lidhje kishte Nikollai me çështjen që po diskutonin?

— Po, — u përgjigj pastaj pa kuptuar se ku do të dilte shefi i tij.

— Ç'dini për të? — pyeti përsëri Artani.

— Është përkthyes në përfaqësinë tregtare të shtetit të tij. Flet shqip shumë mirë dhe për ta përfeksionuar këtë ka hyrë në ambientet shqiptare.

— Vetëm kaq? — Artani nuk ia hiqte sytë Ergysit dhe pyeste vazhdimisht.

— Vetëm kaq. — Ergysi ngriti supet lart, si për të forcuar ato që thoshte. Shefi u çua nga karrikuja dhe përsëri pyeti:

— Po që ka miqësi me Aliun, Stasin dhe Naimin, a e dini?

— Jo. — Ergysi u çua në këmbë dhe iu afrua Artanit, i cili i ishte afruar dritares dhe po pinte cigare.

— Mbage mend mirë atëhere, — filloi të fliste Artani. — Nikollai ka miqësi me të tre, qysh kur këta kanë qenë për studime në shtetin e tij. Nikollai është spiun i kamufluar si përkthyes dhe deri në një farë mase ne e kemi vërtetuar veprimtarinë e tij kundër nesh. Për këtë qëllim ai ka grumbulluar rreth vetes ata të tre. Ndofta Nikollai, për të humbur gjurmët, u tërhoq nga skena dhe vendin e tij e zuri Aleksei. Pas këtij hyri në vull të shoferi. A nuk të krijohet përshtypja sikur Stasi me Naimin nuk kanë pranuar ato çka u ka propozuar Aleksei



dhe këtë propozim e ka pranuar vetëm Aliu? Bile Stasi me Naimin kanë përgatitur opinionin sikur janë grindur me Aliun, por rezulton se miqësia e tyre vazhdon. Pra Aliu mundet që të jetë caktuar përgjegjës i tyre dhe atij i takon të marrë udhëzime nga Aleksei nëpërmjet shoferit të tij. Ky, natyrisht, është një veprim për të larguar dyshimin. Veprimtaria e tyre u ngjan atyre burimeve të nëndheshme që dalin diku, ne i shikojmë, shikojmë prap atje po për çudi ata janë zhdukur. Edhe këta dolën në një çast dhe po fshihen për të humbur gjurmët. Me siguri ata do të dalin prapë. Një herë nxorën kokë në Rinas, pastaj këtu në Tiranë. Tani ndofta nuk do të organizojë takime as në Tiranë e as në Rinas por në ndonjë vend tjetër. Por këtu ka edhe diçka tjetër: as Naimi, as Aliu dhe as Stasi nuk mund të jetë i panjohuri i Rinasit. Karakteristikat që ka denoncuar Tahiri nuk i gjen tek asnjëri nga këta. Atëhere, bukuri, Aleksei do të takohet përsëri me të. Në atë shkëmbim bisedash në mënyrë aq të shpejtë në Rinas, ata nuk kanë pasur mundësi të merrren vesh mirë.

Artani me Ergysin biseduan bashkë për një kohë të gjatë. Herë fliste Artani dhe herë Ergysi. Pastaj Ergysi doli nga zyra. Artani e ndoqi me sy. Tek aftësitë e tij kishte një besim të madh. Kjo çështje sapo kishte filluar. Artani kishte vënë re se Ergysi i kapte dhe i interpretonte mirë faktet. Dhe kjo ia shtonte besimin atij si përgjegjës se Ergysi do t'ia dilte mbanë edhe kësaj detyre. I panjohuri i Rinasit do të gjendej në tërë këto labirinte të ngatërruara ku mendohej ta fshihte Aleksei, dhe kështu do të demaskohej edhe veprimtaria armiqësore e këtij diplomati revizionist.

Kaluan shumë kohë. I panjohuri i Rinasit ngelej përsëri i panjohur. Shpesh veprimet kalonin nga Tirana në qytete të tjera të vendit. Shoferi i Alekseit takohej herë pas here me Aliun. Alekseit vetë jo. Nikollai e kishte ftohur së tepërmi shoqërinë me tre shqiptarët, shokët e tij të studimeve. Po ashtu si më parë, nga sjelljet e Aliut dhe të Naimit të krijohej përshtypa se diçka kishte ndodhur midis tyre. Ata rrinin veç e veç dhe po krijonin shoqëri të re. Artani ngulte këmbë që flokëverdhi të gjendej. I thoshte një mendje se prapa kësaj fshihej diçka tjetër, shumë më e madhe se sa një bisedë e zakonshme. Këtë mendim ia forcuan më tepër takimet e këtij diplomati të huaj me tre shqiptarë që kishin mbaruar studimet në shtetin e tij dhe që sektori operativ kishte vërtetuar se deri në një farë mase ishin vënë në shërbim të Nikollait, që ishte një spiun i regjur. I qe mbushur mendja se pikërisht ai njeri flokëverdhe me xhakaventë sportive, që u largua nga Rinasi me motorr «Java», do të shërbente si një kanal për të hyrë në misteret e takimeve që Aleksei kishte organizuar me Aliun. Stasin, Naimin dhe shoferi i diplomatit të huaj me Aliun. Ngjarjet rridhnin të qeta. Në vështrim të parë asgjë shqetësuese nuk dukej. Por në spiunazh drama luhet në prapaskenë. Dhe Artani pranda ngulte këmbë. Duhej hyrë në prapaskenë.



## 3.

Dimri erdhi me shirat e tij të zakonshme e monoton. Qyteti bregdetar rrihej pa pushim si me kamxhik nga erëra të fuqishme. Retë dilnin në horizont të zeza dhe të frikshme. Ato dukeshin sikur ishin ngarkuar me ujë aty ku horizonti puqej me retë dhe vinin për t'u shkarkuar me tërsëllim mbi qytet. Në dhomën e pritjes të degës së punëve të brendshme qëndronte një burrë, mbi shpatullat e përkulura të të cilit qe vendosur një kokë disi e madhe për atë trup jo shumë të lartë. Në zyrën e shërbimit të rojes oficeri bisedonte në telefon. Ora e varur në mur, me tiktakun e saj monoton, shënonte tetë. Burri me kokë të madhe ishte ulur në një stol e fërkonte duart. Nga goja i dilte avull. Ishte dhjetor. Operativi uli mikrotelefonin dhe pasi hapi një sportel të vogël pyeti qytetarin që ishte ulur në stol:

— Ju çfarë prisni?

Qytetari u çua në këmbë, iu afrua sportelit dhe foli me zë të ulët:

— Dua të takoj kryetarin!

— Duhet të vini në ora 12, — u përgjigj oficeri i rojes nga brenda dhe u bë gati të mbyllte sportelin. Qytetari zgjati dorën ngadalë dhe vuri pëllëmbën e dorës së djathtë para xhamit.

— Jam shofer, — tha — kam udhëtuar tërë natën. Dua të takoj patjetër kryetarin.

— Mos të kanë marrë patentën? — bëri shaka oficeri i rojes.

Qytetari që tha «jam shofer» sikur u prek nga këto fjalë dhe me një ton pak si urdhëronjës tha:

— Dua të takoj patjetër kryetarin. Kam një punë të rëndësishme me të.

— Prit pak, — u përgjigj oficeri i rojes. Pasi foli me dikë në telefon u kthye dhe i tha shoferit:

— Urdhëroni. Po ju shoqëroj në zyrën e kryetarit. Ai po ju pret.

Oficeri i rojes, një djalë i ri, ecte përpara, ndërsa shoferi mbrapa. Kështu ata u futën në një korridor të gjatë.

Kryetari rrinte në tryezën e punës. Kur hyri shoferi, i zgjati dorën. Shoferi pa se në dhomë, përveç portreteve të tjera të varura në mur, ishte dhe ai i Xherxhinskit.

— Për çfarë u munduat? — pyeti kryetari.

Shoferi rrotullonte kapelen nëpër duart e tij tërë kallo. Ai e kishte të vështirë të fliste. Kryetari e shikonte atë dhe nuk kuptonte dot se ç'e mundonte kaq shumë këtë njeri. Ky më në fund tha:

— Unë jam shofer..., — dhe heshti. Kryetari nxori paketën e cigareve dhe ia zgjati shoferit. Ky i fundit nuk e mori. Tha se nuk e pinte. Përfundimisht frynte erë. Nga oxhaku i fabrikës, që dukej nga dritarja e kryetarit, dilte vazhdimisht tym. Ky harkohej nga era e shpërndahej tutje. Pritej të fillonte shi. Kryetari, për ta thyer heshtjen, pyeti shoferin:

— Si quheni?

— Hekuran, Hekuran Saliu, jam shofer në park.

Shoferi heshti dhe ca, pastaj tha:

— Unë jam shofer. Jam mësuar ta fitoj bukën me krahët e mi. Kam tre fëmijë të vegjël. Punoj... Unë nuk e di, mund edhe të gaboj...



— Nuk të kuptoj. Fol më qartë. Pastaj nuk ka pse të gabosh — ndërhyri kryetari. — Ne jemi shokë, edhe po gabove do të të sqarojmë dhe... —Shoferi ngriti kokën dhe tha:

— Dje, në të ngrysur, duke udhëtuar me makinë në drejtim të Vlorës, tek «Shkëmbi i Kavajës», pashë një skenë që m'u duk jo e zakonshme. Dyshoj se prapa saj fshihet diçka tjetër. Ju thashë se po udhëtoja me makinë. Makina të tjera kalonin rrallë, për të mos thënë fare. Tek kthesa në afërsi të shkëmbit kishte ndaluar një veturë e zezë, e huaj. Brenda nuk kishte njeri. Nga ana e djathtë e rrugës, nga gëmushat e bregdetit, po dilte një njeri trupmadh. Ky ishte i huaj. I huaji u fut në makinë dhe u nis me shpejtësi. Unë udhëtoja drejt tyre. Në këtë kohë unë e ndala makinën time. Pashë se nga gëmushat po dilte edhe një njeri tjetër flokëverdhe duke tërhequr një motor. Ai doli në rrugë dhe u nis në drejtim të qytetit tonë. Në atë kohë nxora kokën nga xhami, për të parë targën e motorit, por më kot. Ajo ishte bërë pis, e spërkatur me baltë, të paktën kështu m'u duk mua. Pak më përpara kishte rënë shi, motori ishte futur midis gëmushave e ndoita këtu ai ishte bërë tërë baltë.

Kryetari e dëgjonte me vëmendje ndërsa shoferi vazhdonte të fliste tashmë me një ton të qetë. Siç duket ai gjatë rrugës së kthimit e kishte rikujtuar kushedi sa herë me vete këtë skenë, prandaj dhe i ishte ngulitur mirë në kokë. Pastaj shoferi tha:

— Ju thashë se mund të gaboja dhe ja sepse: ai i huaji, që është takuar me atë flokëverdhin midis gëmushave, punon në ambasadën e një shteti të huaj. Ndërsa flokëverdhin me motor nuk e njoh. Unë për këtë takim dyshoj. Ne e kemi zakon që me

njerëzit takohemi hapur dhe jo ferrave. Ç'donte ai njeri atje larg qytetit tonë? Pastaj pse kish ardhur nga Tirana? Për këtë unë dyshoj, shoku kryetar. Për këtë erdha t'ju lajmëroj. Mbrëmë kam udhëtuar gjithë natën. Çuam në Vlorë mallra dhe u ktheva menjëherë.

Kryetari u çua në këmbë. Tymi i cigares përhapte spirale-spirale nëpër dhomë. Ai u afrua afër dritares, ndërsa shoferi rrinte i ulur akoma. Era pothuajse kishte pushuar fare. Pritej shiu.

— Në çfarë ore kalove aty? — pyeti kryetari.

— Në orën katër, ose katër e gjysmë, — u përgjigj shoferi.

— Motori i c'marke ishte? Apo nuk e vure re? — pyeti përsëri kryetari.

— Edhe po të mos e shikoja fare, por vetëm zhurmën t'i dëgjoja, do ta njihja. Çështje zanati, më kuptoni, besoj. Ishte motor «Java» i përdorur.

Shoferi, që quhej Hekuran, kur fliste për zhurmën dhe markat e motorave e të makinave i ndrisnin sytë. Kryetari, megjithëse shoferi i tha që njeriun me motor nuk e njihte dhe nuk e dinte nëse ishte nga qyteti i tyre apo jo, e pyeti përsëri:

— Po nuk ta kanë zënë sytë fare atë njeri?

Shoferi mohoi me kokë dhe u çua në këmbë. Pas tij u çua kryetari. Kryetari i tha:

— Këto të mbeten në mes nesh. Faleminderit për gjithshka.

Shoferi mbylli derën dhe iku. Nga dritarja kryetari vuri re se shiu kishte filluar të binte me rrëmbim. Si të ishte vonuar për diçka, me të shpejtë mori telefonin.

— Alo, oficeri i rojes! ... shoqërojeni këtë shokun me makinë. Filloi shiu, do të laget.



Oficeri i rojes iu përgjigj se shoferi kishte ardhur bashkë me makinën e tij.

Kryetari u përqëndrua për një çast, diçka i shkrepri në kokë vetëtimthi, ngriti dorezën e telefonit, formoi një numër. Tek priste në telefon t'i delte njeriu i kërkuar rikujtoi edhe një herë sinjalizimin e ministrisë për një takim që ishte kryer në aeroportin e Rinasit midis një të huaji dhe një shqiptari të pidentifikuar. I kujtoheshin karakteristikat e jashtme të shqiptarit, të cilat ishin shkruar në sinjalizim, pastaj përpara i delte fytyra e shoferit që sapo kishte ikur, i cili kishte udhëtuar tërë natën e në mëngjes kishte denoncuar...

Në telefon dëgjohej një zë i mbytur «... Urdhëro... Urdhëro...» ndërsa ai nuk po dëgjonte fare. Kur kjo gjë u përsërit disa herë, atëhere ai nxitimthi tha:

— Alo, centrali, centrali, më lidhni me Tiranën, me ministrinë, të lutem. . .

#### 4.

— Shikoje, — tha Ergysi dhe zgjati një fotografi. Artani thithi dhe një herë cigaren dhe u çua nga karrikja. Pastaj, mori fotografinë në dorë dhe filloi të lëvizë nëpër zyrë. E kishte zakon të vjetër, që sa herë i interesonte diçka, të lëvizte nëpër dhomë. Një shok i kishte thënë njëherë se kjo ishte shenjë e një njeriu nevrrik, por ai e kishte kundërshtuar. Dhe me të vërtetë ai ishte çuditërisht i qetë edhe në situata shumë të komplikuar.

— Kur ke dalë këtu? — e pyeti Ergysin dhe qëndroi përballë tij.

Është fotografia e diplomës, kur mbarova universitetin — u përgjigj Ergysi.

— Dukesh çunak fare, — tha Artani dhe menjëherë mori një pamje serioze. Pastaj, sikur të futej në një kohë të shkuar, mori një pamje të menduar dhe e pyeti Ergysin:

— Këtë do të çosh tek piktori?

— Po, — u përgjigj Ergysi.

— Në ç'brigadë ka qenë dajoja?

— Në të parën.

— Nuk ka asnjë fotografi të tij?

— Jo. Një shoku i tij më tha një herë se kur u çlirua Berati patën dalë në fotografi, por ajo ka humbur. Një gazetar ka shkruajtur diçka për dajon me rastin e përvjetorit të rënies, por shkrimi është mirë të dalë edhe me një skicë në vend të fotografisë.

— Ti i ngjan më shumë atij nga gjithë pjesëtarët e familjes?

— Po, shoku Artan.

— Mirë, Ergys, mirë. Shko tek piktori dhe ktheu shpejt. Kemi një lajm të rëndësishëm nga Durrësi. Më duket se i panjohuri i Rinasit nuk do të jetë më i panjohur.

— Ashtu? — shfaqti habinë Ergysi. — Po si, si është puna?

Artani qeshi me Ergysin. E kapi për supi dhe e shikoi drejt në sy.

— Shko tek piktori, shko dhe pastaj bisedojmë. Sot do të nisemi për në Durrës.

Ergysi u largua, ndërsa Artani u ul në tryezën e punës. Përjashta shiu kishte pushuar. Strehët e çative lëshonin pikat e fundit. Megjithatë



horizonti ishte i zi. Vetëm tek-tuk zbardhonin disa re.

Ergysi u kthye pas pak. Artanin e gjeti në tryezën e punës. Diçka po shkruante. Kur hyri Ergysi, ai kërkoi dikë në telefon. Sinjali i telefonit tregonte se numri ishte i zënë. Artani i tha Ergysit.

— Mbarove punë?

— Po, u përgjigj Ergysi.

— Tani do të nisemi.

Artani kërkoi përsëri numrin. Një zë i trashë u dëgjua në receptor:

— Po, tani po e dërgoj.

Makina erdhi shpejt dhe mori rrugën në drejtim të Durrësit. Brenda ishte Artani me Ergysin. Rrugët ishin të lagura nga shiu, që sapo kishte pshuar. Shoferi, një burrë plak, vështronte me kujdes rrugën.

Udhëtimi për në Durrës ishte kaq i shpejtë sa Artani me Ergysin nuk vunë re as peisazhin kafe në të dy anët e rrugës, as freskinë e kësaj mbasditjeje të lagur nga shiu. Ata po mendonin për të panjohurin, i cili së shpejti do të gjendej. Kjo gjë i gëzonte të dy, por edhe i shtynte në mendime për të ardhmen. Më tutje i priste një punë më e madhe. Ergysi kujtonte edhe atë thënien e Artanit, ku ai e krahasonte të panjohurin me ato burimet e nëndheshme që diku humbasin e diku dalin prapë.

Udhëtimi zgjati rreth një orë. Aty më të ngrysur ata hynë në qytetin bregdetar. Plazhi i qytetit ishte i njohur në të gjithë vendin për bukurinë e tij! Tani ky plazh për Artanin dhe Ergysin kishte dhe një kuptim tjetër. Ai ishte një vend takimi i atyre njerëzve që po përpiqeshin të organizoheshin

kundër pushtetit popullor. Kur makina hyri në qytet, rrugët ndriçoheshin nga dritat. Kishte rënë mbrëmja...

5.

Artani dhe Ergysi, pasi kishin dëgjuar kryetarin e degës, ishin ulur dhe po pinin të qetë cigaren. Ora ishte 8 e mëngjesit dhe koha sikur ishte rregulluar disi. Re të ngarkuara me shi lëviznin grumbuj-grumbuj dhe largoheshin tutje në horizont. Hapësira të mëdha e të kaltra krijoheshin herë pas here në qiell. Kryetari në këtë kohë diçka shkruante.

— Të dalim pak, sa të mbaroni punë? — pyeti Artani duke u drejtuar nga kryetari.

— Ja, mbarova. — tha kryetari dhe, mbasi la lapësin, vazhdoi: — Më duket se të tëra karakteristikat që përshkruajti shoferi përkojnë me ato që ka thënë nëpunësi i Rinasit.

— Po, — tha Artani — ka mundësi që ky të jetë nga ky qytet. Edhe ne këtu duhet ta përqëndrojmë punën.

— Në fillim — foli Ergysi — mendoj se duhet të pyesim policin e trafikut në udhëkryqin e hyrjes së qytetit.

— Dhe pastaj...!? — pyeti kryetari. Artani, kur dëgjoi Ergysin, e kuptoi mirë qëllimin e tij dhe në fytyrë iu shfaq një shprehje miratimi.

— Kjo do të na japë mundësi t'i afrohem i sadopak identifikimit të tij, mundet dhe plotësisht.

— Po si? — ishte kryetari që pyeste.

Ergysi lëvizi pak karriken nga vendi dhe tha:



— Ditën kur është kryer takimi tek «Shkëmbi i Kavajës» flokëverdhi me motor ka ardhur këtu në qytet. Për të hyrë këtu, ka kaluar nga rruga kryesore. Tjetër rrugë nuk ka. Cili nga punëtorët e policisë ka qenë me shërbim atë mbasdite në udhëkryq? Pikërisht ky duhet pyetur.

— Nuk është mendim i keq, — ndërhyri Artani — por është vështirë që polici i shërbimit të mbajë mend se kush hyn e kush del nga qyteti me motor «Java». Por, sidoqoftë, unë nuk jam kundër këtij mendimi dhe polici duhet pyetur patjetër, — përfundoi Artani. Kryetari bëri një lëvizje të kokës në shenjë miratimi. Ergysi tha:

— Me sa di, punëtorët e policisë që kryejnë shërbimin në trafik zakonisht nuk ndërrohen. Nga kjo, ata njohin shumicën e shoferëve dhe të automjeteve të qytetit. Madje ata janë në gjendje të dallojnë makinat e qytetit të tyre pa e parë targën. Puna të krijon disa reflekse të caktuara dhe... Në qoftë se «I panjohuri» pasi është takuar me Aleksein ka hyrë në qytet, ai me siguri është vënë re nga polici i trafikut në udhëkryq. Nga ajo kohë kanë kaluar dy ditë dhe ai s'besoj t'i ngatërrojë ditët. Ai mund të na i përshkruajë shumë mirë ata që kanë hyrë në qytet me motor, bile edhe mund ta njoh se kush është njeriu flokëverdhe që ka motor «Java». Mund të jenë dy ose më shumë të tillë, kjo ka fare pak rëndësi. Atëhere ne i afrohem më shumë.

Kryetari dhe Artani shikuan njëri-tjetrin në sy. Dukej që mendimi i Ergysit u përqueu. Kryetari mori në telefon komandantin e repartit të policisë, pyeti se kush kishte qenë me shërbim në udhëkryq para dy ditësh dhe, si mori përgjigje, i tha që ta dërgonin

në zyrën e tij. Pas pak, në zyrë hyri një polic.

Duke u drejtuar nga punëtori i policisë, kryetari i tha:

— Këtë të diel do ta fitojmë ndeshjen e futbollit, si thua?

— Patjetër, mbrojtjen e kemi beton.

— Beton e patëm dhe javën e kaluar, po doli dërrasë e kalbur. — Kryetari qeshi. Po kështu edhe polici

— Ajo ishte rastësi, — tha pastaj punëtori i policisë.

— Ramiz, — kështu e quanin punëtorin e policisë, — pardje mbasdite, ju keni qenë me shërbim tek udhëkryqi në hyrje të qytetit — i tha kryetari.

— Po, — u përgjigj Ramizi

Artani dhe Ergysi dëgjonin me vëmendje.

— A kini venë re se kush ka hyrë me motor «Java» aty nga ora katër, ose katër e gjysmë nga rruga e plazhit për në qytet?

Në zyrë, për një çast sundoi heshtja.

Ramizi u kthye nga Artani dhe Ergysi. Këta i shikonte për herë të parë. I pa me vëmendje për një kohë të gjatë. Kryetari vuri re qëndrimin e tij dhe ndërhyri:

— Harrova t'ju paraqes: Këta të dy, — dhe u drejtua nga Artani dhe Ergysi, — janë dy shokët tanë, nga ministria, ndërsa ky — dhe u drejtua nga polici, — quhet Ramiz, punon në polici.

Ramizi u takua me dy oficerët e ministrisë dhe tha:

— Është një çikë vështirë, shoku kryetar, të mbash mend se kush ka hyrë gjatë tetë orëve në qytet me motor.



— E dimë që është vështirë, por përpiqu t'i kujtosh, — tha kryetari.

Ergysi fërkonte gishtërinjtë me njëri-tjetrin. Tek ky variant ai kishte pasur besim, por tani mendoj se pak mundësi kishte për të identifikuar të panjohurin me anën e punëtorit të policisë. Megjithatë shpresat nuk i kishte humbur akoma dhe ndërhyr në bisedë. Ai i tha punëtorit të policisë:

— Është një njeri me flokë të verdhë... bjond.

— A, kështu po! — tha punëtori i policisë.

Artani lëvizi nga vendi. Kryetari nxori paketën e cigareve. Ergysi u çua nga karrikja për një çast. Ramizi vazhdoi:

— Jo vetëm atë ditë. Por këtë flokëverdhe, në qoftë se është ai që u intereson juve, e kemi mik të përhershëm ne që bëjmë shërbim në trafik. Ai e bën shpesh rrugën për në Tiranë, sidomos kur ka ndeshje futbollit. Bile ai na komenton edhe ndeshjet. Është tifoz i madh. Pikërisht pardje mbasdite ai u kthye nga rruga e plazhit. Tek ura ndaloj, bëmë muhabet dhe miqësisht i dhashë një këshillë.

— Për çfarë? — pyeti kryetari.

— Për motorin. Ka një motor shumë të mirë dhe kohët e fundit nuk kujdeset shumë për të. Edhe atë ditë e kishte tërë baltë, bile edhe targa nga mbrapa nuk i dukej mirë.

Ndërsa Ramizi fliste, kryetarit i kujtohej biseda me shoferin në zyrën e tij, që s'mundi të shohë targën e motorit të flokëverdhit pasi e kishte të ndotur me baltë. Ergysi donte të ndërhynte sa më shpejt, ta pyeste Ramizin se si quhej ky njeri, ku punonte, por e përmbajti veten. E la të fliste lirisht atë dhe me të vërtetë Ramizi po e jepte të plotë ti-

pin me motor, sipas të gjitha denoncimeve që kishin ardhur për të.

—...Pasi biseduam — vazhdonte të fliste Ramizi — ai iku për në qytet. Siç duket për në shtëpi. Ai quhet Estref Lera dhe punon në oficinën «X» të qytetit tonë. Mund ta takoj kur të dua.

Kryetari kishte pirë gjysmën e cigares dhe rrinte i qetë, me fytyrë të mbështetur në njërën pëllëmbë. Pastaj u drejtua nga Artani dhe tha:

— Besoj mjafton.

Artani pohoi me kokë. Po kështu dhe Ergysi. Ramizi, si u përshëndet me të gjithë, u largua.

\*  
\*   \*  
\*

Më në fund çështja po sqarohet pjesë-pjesë. Estref Lera, sipas të gjitha karakteristikave të nëpunësit të Rinasit dhe shoferit, ishte «i panjohuri» që ishte takuar me diplomatin e ambasadës së huaj. Po dyshimi qëndron gjithmonë dyshim. Ai duhet vërtetuar. Dhe për këtë u morën të gjitha masat. Estref Lera dikur kishte qenë për një kurs përfeksionimi në shtetin e Alekseit. Kjo e forconte dyshimin për të, po ta lidhje këtë me takimet e fshehta që bënte.

Pas kësaj, u konstatuan shumë gjëra të tjera. Estref Lera herë pas here shkonte në Tiranë dhe takohej me Aliun. Pastaj vinte në Durrës përsëri. Këtu ai organizonte takime me një përfaqësues tregtar të huaj. Të gjitha këto vërtetonin plotësisht se Estref Lera ishte i panjohuri që ishte takuar në Rinas dhe tek «Shkëmbi i Kavajës». Po kështu të krijohej menjëherë bindja se Estrefi ishte anëtar



i grupit të mundshëm që vepronte në qendër. Ndryshe nuk kishte si shpjegohej takimi i tij me Aliun. Në Tiranë edhe shoferi i Alekseit i ndërpreu takimet me Aliun. U konstatua se Estrefi takohej vetëm me Aliun dhe përfaqësuesin tregtar të huaj në Durrës. Kjo do të thoshte se faza e organizimit të grupit kishte mbaruar dhe ata ishin hedhur në aktivitet. Por si duhej vepruar për t'u njohur plotësisht me qëllimet e këtij grupi?

## 6.

Ajo rrugë rrihej dendur si nga makinat ashtu dhe nga njerëzit. Shoferët, të cilët mërziteshin së tepërmi kur udhëtonin vetëm, thoshin se kjo rrugë kalohet mirë, pasi në çdo rast ka lëvizje dhe vetëminë në timon nuk e ndjen Atë ditë, midis grumbullit të makinave, shumica e të cilave ishin kamionë të mëdhenj të mbushur me mallra, dallohej një veturë e zezë. Ajo parakalonte makinat me radhë dhe dukej si një njeri që nxiton midis turmës së qetë. Pasi parakaloi me radhë dy skoda, ajo e ngadalesoi shpejtësinë. Para kishte një kamion të ngarkuar kaq shumë me lëkurë, sa të dukej sikur ato nga çasti në çast do të binin. Kamioni nuk po i hapte rrugën. Siç duket shoferi nuk shikonte në pasqyrë këmbënguljen e veturës së zezë, që i afrohej kamionit shumë afër, madje as borinë e veturës, që binte me nervozizëm, nuk e dëgjonte. Shoferi i veturës iu afrua së tepërmi makinës me lëkurë, thujse do të përplasej me të, dhe vetëm atëhere, kamioni u hodh me të shpejtë nga krahu i djathtë. Kjo lëvizje ishte aq e shpejtë, sa dukej sikur

vetë kamioni kërkonte të falur për këtë. Vetura pastaj çau rrugën e drejtë e të gjerë. Shoferi i saj u qetësua, nxori paketën dhe e ndezi në ecje e sipër. Kështu eci nja dhjetë minuta, duke thithur cigaren e duke mbajtur timonin në dorë. Pastaj hapi radion. Zëri i spikeres dëgjohej qartë. Kishte program me muzikë. Një grup polifonik i Jugut këndonte një këngë për Stalinin. Shoferi u kujtua. Ishte 21 dhjetor. E mbylli radion me nervozizëm dhe heshtja sundoi në kabinën e mbyllur të «Zimit» të zi. Humbi në kujtime dhe kështu udhëtoi për disa sekonda. E solli në vete frenimi i makinës, që e bëri vetë instinktivisht. Disa lopë kishin dalë para veturës. Priti deri sa ato liruan rrugën dhe makina u nis përsëri. Kështu udhëtoi edhe pak, kur u dukën shtëpitë e para të qytetit. «Edhe pak — tha me vete. — Duhet kujdes». Vetura ecte përpara me shpejtësi dhe papritur u përplas me një pemë të lartë ndanë rrugës. Shoferi u trondit së tepërmi. Hapi derën e veturës e u hodh me të shpejtë në rrugë. Disa njerëz që u ndodhën aty rrethuan në çast veturën. Shoferi dukej shumë i shqetësuar. Parafangua e krahut të djathtë ishte shtrembëruar.

— Si ndodhi? — pyeti një qytetar.

— Pakujdesi, — u përgjigj shoferi. Ata që ishin rrotull kuptuan nga theksi se shoferi ishte i huaj. Qytetarët hodhën sytë nga targa e makinës. Në të ishte shënuar T D.

— Këtu afër është një oficinë, makina rregullohet shpejt, — tha qytetari që e kishte pyetur në fillim shoferin.

— Ku? — ngriti veshët shoferi.

— Ja, kjo përballë, — tha përsëri qytetari.

Shoferi u gëzua shumë. Me të vërtetë jo më



larg se 30 metra ishte një ofiçinë. Kjo do të thoshte se makina do të rregullohej shpejt dhe ai do të vazhonte i qetë udhëtimin. Ai u drejtua nga porta e ofiçinës. Roja nuk e lejoi të futej brenda, por ngriti telefonin dhe foli me dikë. Shoferi priste tek parmakët rrethues të oborrit. Qytetarët shikonin veturën e prishur ndanë rrugës. Pas pak nga ndërtesa e ofiçinës doli një punëtor duke fshirë duart me leckë. Ai bisedoi me shoferin, siç duket pranoi që t'ia rregullonin veturën, ndërsa shoferi shkoi pranë makinës së tij.

— Ju lutem më ndihmoni, sa ta fusim brenda! — iu drejtua shoferi i huaj qytetarëve që rrinin aty afër. Ata, pa folur, filluan të shtyjnë veturën. Ajo filloi të ecte dhe shoferi e drejtoi atë nga oborri. Roja kishte hapur portën. Makina u fut brenda në ofiçinë dhe shoferi doli prej saj.

— Tani do të vijnë dy punëtorë dhe do t'ju ndihmojnë që të rregullohet sa më shpejt, — tha punëtori që e lejoi atë të futet brenda. Pastaj ai u largua e bashkë me të edhe qytetarët që kishin shtyrë veturën. Shoferi nuk harroi t'i falenderonte ata. Për disa minuta ai ngeli vetëm. Hodhi sytë lart. Shiu që kishte rënë kishte pastruar atmosferën. Konturet e ndërtesave dhe të kodrave shquheshin qartë. Bile të dukej sikur ambienti e ndërtesat ishin afruar më shumë me njëra-tjetrën. Edhe kodrat dukeshin si më të afërta sa me dy të kërcyera mund t'i arrije. A ishte ky një iluzion optik apo një ndjenjë gëzimi që po provonte ai? Kjo ishte e papërcaktuar për shoferin e veturës me targë diplomatike. Atij i dukej se këto ishin shkrirë të dyja, pasi gjithmonë kur bie shi ambienti sikur laget e zhduken largësitë; dhe e dyta, që për të tani ishte më e rëndësishme,

punët deri tani po i shkonin si jo më mirë. Për-  
plasja nuk kishte shkaktuar ndonjë dëm të madh  
dhe sipas planit të caktuar ai tani ndodhej brenda  
oborrit të oficinës. Tani pritej të vinte ai... Atëhere  
ai do të merrte porosinë në vendin e caktuar dhe...  
por këtu mendimet i mbetën. Vërtet që plani ishte  
studjuar në ambasadë më së miri por nuk i dihej.  
Ndezi dhe një cigare. Kjo ishte e dyta që ndizte  
brenda 15 minutave. U mërzit duke ndenjtur kështu  
dhe filloi të hedhë sytë majtas e djathtas. Përsëri  
sytë i vanë tek një parullë shkruar me germa të  
kuqe. E lexoi përsëri deri në fund. Kjo ishte një  
parullë e vjetër, por tani atij i dukej sikur kishte  
një kuptim tjetër. Në të ishte shkruar: «Pa demas-  
kuar deri në fund revizionizmin, nuk mund të luf-  
tohet si duhet imperializmi». Këtë parullë ai e kishte  
lexuar edhe herë të tjera, por kohët e fundit i dukej  
se ajo po shfaqej më shpesh nëpër fasadat e ndërte-  
save. Kështu vazhdoi të lexojë edhe parulla të tjera  
për një kohë të gjatë dhe një buzëqeshje e shtirur u  
duk në cepat e buzëve. Kështu do të kishte vazhduar  
për një kohë të gjatë, sikur nga dera e madhe e ofi-  
cinës të mos kishin dalë dy punëtorë. Cigarja iu var  
në buzë dhe fërkoi duart. Një ndjenjë gëzimi e pu-  
shtoi në çast. Roja ngaqë s'kishte se ç'të bënte, ki-  
shte ndjekur lëvizjet e shoferit dhe kur vuri re gje-  
stet e tij të fundit tha me vete: «I varfri, ka men-  
duar se nuk do t'ia rregullonin, siç duket nuk na  
njej mirë që ne e mbajmë fjalën!»

Dy punëtorët u afruan, u takuan me shoferin  
e huaj, ndërsa ky i fundit u tha:

— Ju jeni ata që... — po nuk e mbaroi fjalën,  
pasi njëri nga ata, ai më i gjati, tha:

— Po, të fillojmë shpejt.



— Prit, prit ta ndezim nga një herë, — u tha shoferi.

— Faleminderit, — tha punëtori tjetër pak më i shkurtër se i pari, bjond e me një fytyrë të hequr, — unë nuk e pi

— Atëhere ndizeni, ju, — tha shoferi duke u drejtuar nga punëtori i gjatë.

Ndërsa shoferi me punëtorin e gjatë po ndiznin cigaren, flokëverdhi tha:

— Unë po futem poshtë, të shikoj se çfarë dëmtime ka. — Pastaj, si u shtri poshtë makinës, filloi të godasë me çekiç pjesën metalike.

— Hë, si duket? — pyeti shoku i tij, që ishte në këmbë.

— Një gjë e vogël. Dhjetë minuta punë, — u përgjigj tjetri.

— Atëhere fillojmë, — tha ai që ishte në këmbë dhe mori veglat që i kishte lënë në tokë.

Shoferi ndiqte me vemendje lëvizjet e punëtorëve. Vjedhurazi ai hidhte nga një vështrim tek flokëverdhi, që ishte shtrirë poshtë makinës. Për një çast sytë e tyre u takuan, por ato të flokëverdhit, që ishte poshtë makinës, qëndruan si të ngrirë. Po kështu edhe ato të shoferit. Ky shikim i ngjante më tepër një takimi të dy copërave të vogla akulli, të ftohta, të ftohta. Shoferi i bëri me shenjë që të shikonte përsëri poshtë makinës dhe në çast u dëgjua përsëri goditja e çrregullt e çekanit, që i ngjante një dridhjeje të fuqishme e me përmasa të mëdha. Pastaj sytë e flokëverdhit u takuan përsëri me ato të shoferit. Tani ata i ngjanin atij akullit që sapo ka nisur të shkrijë nën rrezet e një dielli të ngrohtë. Pas kësaj shoferi nxori paketën nga xhepi, u ktheu shpinën punëtorëve që punonin dhe filloi të

eci i qetë nëpër oborr. Donte të shkëmbente cigaren me dikë. Në oborr nuk pa asnjëri. Vetëm roja qëndronte te kabina e vogël në hyrje të oficinës. Shkoi tek ai dhe i zgjati paketën. Roja vuri dorën në zemër, mori cigaren dhe e vuri në vesh. Pastaj nxori kutinë e duhanit dhe, duke ia zgjatur shoferit, i tha:

— Dridhe një herë, është duhan vendi.

— Faleminderit, — tha shoferi, — por nuk di ta dredh.

— E dredh unë, — tha plaku. Pasi ia bëri cigaren gati, roja, një plak rreth të gjashtëdhjetave, tha:

— Nga të kemi, mor shok?

Shoferi tha emrin e shtetit të tij.

— Mos more, po pse s'më the që në fillim, mor burrë. Ti e flet mirë shqipen.

— Ja, njëlloj është, e thashë tani. Pastaj gjuha juaj është e bukur dhe mësohet shpejt, — tha shoferi.

— Edhe aq e lehtë për t'u mësuar nuk është, xhanëm, — mërmëriti plaku, dhe shtoi: — Turku ndejti 500 vjet dhe nuk e mësoi dot. — Plaku, pasi tha këto fjalë, qeshi. Pastaj ai rrrutulloi qylafin në kokë dhe u çua në këmbë.

Plaku pastaj hapi një bisedë, por shoferit nuk i erdhi mirë. Donte të largohej, por ku drejtin i doli ky plak tani e i hapte një bisedë të tillë? Mos ishte diçka e organizuar? Kjo s'kishte mundësi. Ndofta, meqë është 21 dhjetori, plakut iu kujtua ai... Në ndihmë i erdhi boria e veturës së tij. Ktheu kokën anej. Të dy punëtorët po ia bënin me dorë. Makina ishte gati. Pa i thënë gjë plakut, shoferi u largua me



të shpejtë. Kur erdhi pranë veturës, punëtori me trup të gjatë i tha:

— Gati e keni, mund të shkoni. — Punëtori tjetër, flokëverdhi, u përshëndet me shoferin dhe u largua. Pas pak, plaku hapi dyert e mëdha dhe vetura e zezë me targë diplomatike doli nga oborri i oficinës. Ndërsa kjo largohej, si një njollë e zezë, roja mendonte me vete: «Jo vetëm duhan që s'dinte të dridhte, por as muhabet s'bënte dot. S'm'u duk burrë i mirë...

\*  
\*       \*  
\*

Punëtori flokëverdhtë, si u nda nga shoferi, u fut në ndërtesën e madhe të oficinës. La në një qoshe veglat e punës dhe u nis për në repart. Kaloi me radhë të gjitha repartet dhe u fut në një korridor të gjatë ku nuk kishte fare lëvizje. Ishte kohë pune. Futi dorën në xhep dhe u afrua afër dritares. Hodhi një herë sytë rreth e rrotull dhe pastaj nga xhepi nxori një letër të palosur në formë trekëndëshi. Me duart që i dridheshin nga emocioni filloi ta hapte, dhe atje lexoi:

«Në qoftë se je acaruar me Valentinën, atëhere bëj divorc të përkohshëm... deri sa të zbutet... Ne të kemi gjetur një «Valentinë» tjetër më të bukur. Mund ta takosh të enjten në ora 17.30 tek plazhi i vetëmuar.

«Shkesi»

— Na ishte një herë një burim i nëndheshëm — nisi të flasë Ergysi. Dy punëtorët operativë qeshën, pasi ishte kushedi e sata herë që Ergysi e niste kështu fillimin e «përrallës» ndërsa po prisnin Artanin.

— ...dhe një njeri i etur, i cili ruajti ditë e ruajti net deri sa e gjeti atë burim — tha Artani i cili kishte hyrë në çast.

— Por ujë në të nuk piu, — plotësoi Ergysi. Në dhomë plasi e qeshura. Ergysi qeshte me të madhe.

Artani, kur hyri në dhomë, si zakonisht filloi të bënte shaka me të gjithë. Sytë e tre punëtorëve operativë u drejtuan nga ai. Artani e kuptoi. Ata prisnin që ai të fliste. Madje ata për këtë kishin kohë që e prisnin. Artani do t'i njihte ata me rezultatet e para në hetuesi.

— Atëhere, fillojmë, shokë, — tha Artani dhe pastaj vazhdoi: — Njeriu i arrestuar, Estrefi, është një element i vënë në shërbim të zbulimit të huaj revizionist, të cilin e mban në lidhje Aleksei. Estrefi është bashkuar me ata mbi bazën e pikëpamjeve të tyre borgjeze. Ky i fundit këto gjëra i ka shfaqur prej kohësh dhe sidomos gjatë periudhës që ka qenë jashtë shtetit, në një kurs perfeksionimi. Ky njeri është edhe i degjeneruar moralisht, vjedhës i shokëve të tij. Gjatë periudhës së kursit jashtë shtetit ka vjedhur shokët dhe organet e shkollës dhe të policisë ia mbuluan vjedhjen. Mbi këtë bazë atë e kanë rekrutuar dhe e hodhën në aktivitet spiunazhi kundër vendit tonë. Estrefi u ka shërbyer atyre me sa ka pasur mundësi...



Artani fliste e fliste. Ai në këto çaste nuk u ngjante aspak atyre tregimtarëve që të lënë gojë-hapur me ato që thonë. Për të këto ishin mbledhje pune. Ai, kur fliste, u ngjante atyre komandantëve në luftë që u sqarojnë situatat vartësve, u japin detyra dhe tregojnë vështirësitë. Edhe kjo sallë ku ishin mbledhur ata sot u ngjante atyre çadrave luftarake ku bëhen plane që do të zbatohen në çast, pasi të dilet prej andej. Artani filloi të fliste për letrën që kishte marrë Estrefi nëpërmjet shoferit Ai u spjegoi shokëve:

— E deshifruar kjo letër do të thotë: «Në qoftë se ke rënë në sy të sigurimit shqiptar, atëhere ndërprei takimet me nëpunësin tregtar deri sa të ftohet situata. Por ne të urdhërojmë të lidhesh me një njeri tjetër, më të paekspozuar. Atë mund ta takosh të enjten, në ora 17.30 tek Shkëmbi i Kavajës». Dhe «Shkesi» është Aleksei — tha më në fund Artani. — Prandaj, djema, sot është e martë, deri të enjten në ora 17.30 kemi 48 orë kohë. Ne duhet të veprojmë me guxim dhe zgjuarsi. Duhet iniciativë. Koha nuk pret. Qendra është lajmëruar. Për planin tonë presim përgjigje nga Tirana. Ajo duhet të vijë së shpejti.

Ndërsa Artani fliste, në mendjen e të tre punëtorëve operativë, të cilët dëgjonin me sytë katër, krijoheshin pikat nëpër të cilat do të kalonte i gjithë operacioni. Artani, si për t'i dhënë fund bisedës, tha:

— Ne deri tani kapëm njërën rrëkezë dhe me anë të saj duhet të depërtojmë deri në burim e të përcaktojmë hollësisht natyrën e grupit, qëllimet dhe të gjitha gjërat e tjera. Pra takimi ditën e enjte do të na vlejë si fillim i një operacioni...

Punëtorët operativë, dhe sidomos Ergysi, e

kishin kaluar atë fazë kur studjonin «sëmundjen». Ata tani i njihnin mirë «pacientët», kishin mjetet e duhura dhe operacionin do ta drejtonte një «kirurg» i zoti e me eksperiencë siç ishte Artani.

Nuk vonoi dhe përgjigja nga qendra erdhi. Atë e mori në dorë Artani dhe me sytë që i shkëlqenin lexoi fjalët:

«LE TË FILLOJË OPERACIONI...»





## KRISMA NËPËR NATË

*Kushtuar dëshmorit I. Dushku*

Deli Dushku është një burrë rreth të shtatëdhjetave. Vitet vërtet kanë bërë të tyren, por ai mbahet i fortë dhe ka një gjallëri të madhe. Me të u takova një ditë gushti në Lezhë. Bisedën e filloi ngadalë dhe pastaj humbi në kujtime. Po mundohem të tregoj ato çka më tha ai.

Shtatori i vitit 1957 nuk kishte dalë akoma. Shirat kishin filluar para kohe. Të mbjellat i kishim akoma në arë e më kujtohet se ato ditë ishim të shqetësuar për fatin e tyre. Kisha punuar gjithë ditën e aty më të ngrysur po rrija ndanë pragut të shtëpisë e po bisedoja me një shok. Bisedën e ndërpreme kur dëgjuam një zë që thërriste:

«O Deli, o Deli». U ngrita në këmbë e u përgjigja. Njeriu matanë gardhit më tha që t'i afrohesha. Kur u afrova dëgjova fjalët «Hajde, o Deli, e merr këtë letër». Menjëherë mendja më shkoi tek Ibrahim, djali që shërbente në kufi. Ai shpesh më dërgonte letra. Sa herë m'i lexonin më përmallonin. Ibrahim pyeste vazhdimisht për shëndetin tim, për të jëmën, për motrat e vëllezërit e tij. Se unë kam pasur shumë fëmijë. Ata ishin tetë. Pas këtyre Ibrahim shkruante për jetën në kufi, për shokët.

Nuk di pse ai zë që më foli prapa gardhit më ndolli një ndjenjë jo të mirë. Në qoftë se ishte letër, atë mund të ma jepnin edhe të nesërmen. Mendja më shkonte tek shumë gjëra. Djali shërbente në kufi e atje armiqtë ishin shumë pranë. Ata ishin të pabesë dhe, sipas tregimeve të djalit, shpesh provokonin.

— O Deli! Hajde merre telegramin! — tha përsëri zëri prapa gardhit.

— A është letër, a telegram? — pyeta dhe u afrova pranë.

— Telegram, telegram...

— He çka thotë, he burrë?

— Ibrahim është sëmure, — më tha njeriu të cilit i isha afruar. Ai ishte kryetar i këshillit. Tani që isha ballë për ballë me të, vura re se edhe dy



burra të tjerë ishin me të. Me ta kisha punuar ditën, prandaj i pyeta:

— Po ju, a nuk shkuat në shtëpi?

— Jo, — m'u përgjigj njëri prej tyre. — Shkuaam njëherë andej nga këshilli, takuam kryetarin, e meqë kishe këtë telegram thamë të ta sillnim sonte.

— Mirë bëtë. A është sëmure Ibrahimimi apo i ka ndodhur?...

— Jo, or Deli. Po të kishte gjë tjetër ta thoshnim. Telegrami thotë: «Ibrahimimi është sëmure, i shtruar në spital. Po pate mundësi hajde».

— Si thua, Deli, a do të nisesh? — Ishte kryetari i këshillit që më pyeste. Me të njihesha mirë. Në sytë e tij dhe të dy bashkëfshatarëve të tjerë vura re një shqetësim. Ishte një afërsi ajo dhembshuri që na kishte lidhur e mbajtur fort gjithë jetën. Në të tilla raste ne i ishim ndodhur kurdoherë afër njëri-tjetrit.

— Ju faleminderit shumë, — u përgjigja i prekur. Kryetari i këshillit nuk po largohej. Të tre u futën bashkë me mua brenda.

— Si thua, Deli, për çfarë ke nevojë? Rruga është e gjatë, — më pyeti ai që rrinte në krah të Sokolit, kryetarit të këshillit.

— Për asgjë. Do të nisem nesër qysh herët. Do të marr edhe plakën me vete, — u thashë dhe u zgjata kutinë e duhanit.

— Ik pa merak. Për shtëpinë kujdesemi ne, — më tha Sokoli. Ata ndejtën me mua një copë herë, pastaj u larguan. Nata pothuajse kishte rënë plotësisht. Të tre burrat dukeshin si hije. Nga fusha përballë ndihej aroma e ngrohtë e tokës. Kënga e bulktheve kishte formuar një kor e zhurma e tyre kri-

jonte një monotoni aq të këndshme për veshin e fshatarit. Nuk di as vetë pse duke ndenjtur vetëm m'u kujtua Ibrahimimi para se të shkonte ushtar. Ai e donte shumë tokën dhe tek dëgjoja këngën e bulktheve m'u përfytyrua duke ndenjtur i menduar ndanë tokës. Ne ishin lidhur shumë me të. Ajo ishte e paktë dhe vetëm pushteti popullor me bonifikimet që bëri na i zgjeroi. Dhe ne që ia dinim vlerën, e donim shumë. Kjo dashuri iu fut në gjak edhe Ibrahimimit. Vetëm ai që është rritur pranë tokës, që kupton atë frymëmarrje të fuqishme të dheut, që shijon aromën e ngrohtë e meloditë çuditërisht të ngatërruara të bulktheve, mund ta kuptonte Ibrahimimin kur rrinte i menduar për orë të tëra ndanë arës së sapolëruar. Në fëmijëri syri i tij ishte mësuar të shikonte ujë dhe moçal para shtëpisë. Përjashta nuk mund të rrije dot: mushkonjat të nguleshin ngado. Këtë nuk do ta harronte kurrë. Por edhe diçka tjetër, akoma më tronditëse i kishte ngelur në kujtesë. Unë punoja në tokë të botës, të bajraktarit. Kthehesha vonë, shumë vonë, i rraskapitur nga puna, i lodhur sa s'kishte ku të shkonte më. E megjithatë nuk harroja të përkëdhelja fëmijët, e midis tyre domos Ibrahimimin, i cili atëhere ishte i vogël. E merrja në prehër e ai më shikonte drejt në sy. Më vështronte shumë e nuk fliste. Fëmija nganjëherë sikur piqet para kohe, merr një hije serioziteti. Duket sikur varfëria dhe skamja janë më të kapshme për ta. E shikoja ashtu serioz Ibrahimimin dhe, të them të drejtën, më vinte të pëlçisja nga marazi. Atëhere ishin kohë të tjera dhe unë ndoshta kisha atë dëshirë që ka çdo prind: fëmija i tij të jetë i lumtur. Por lumturia e fëmijëve nuk ekzistonte në atë kohë. Bashkë me moshatarët e tjerë Ibrahimimi lindi e u rrit midis



luftës për çlirim e transformim, ai lindi aty nga viti 1937 në Balldre të Lezhës. Është e vështirë të parafytyrosh Balldrenin e viteve të paraçlirimit.

Ime shoqe, si çdo nënë, u trondit kur mori vesh për telegramin. Vendosëm që të nesërmen të nisehim për në Korçë. Natën dëgjoja plakën që pëshpëriste nëpër gjumë fjalë pa kuptim. Bënte një gjumë të shqetësuar.

Në Korçë mbërritëm aty nga ora dymbëdhjetë e natës. Binte vazhdimisht shi. Ai nuk na u nda qysh kur i hipëm trenit në Durrës. Nëpër rrugët e qytetit kishte pak njerëz. Ishim udhëtarët e vetëm. Shoferi i makinës, një djalë i ri që këndonte në timon, na shoqëroi deri në hotelin më të afërt. Edhe ai nuk ishte vendës. Dyert e hotelit ishin mbyllur. Roja, siç duket, flinte. Trokitëm. Asnjë përgjigje. Trokitëm më me forcë. Një zë përgjumësh na u përgjigj nga brenda e pastaj dera u hap.

— Në çfarë dhome jeni? Pastaj pse me kaq vonesë? Hoteli mbyllet në ora 11! — Ai që foli ishte një plak. Gjumi akoma nuk i kishte dalë. Mbi supe kishte hedhur një pallto disi të vjetëruar. Përfjashta shiu vazhdonte të binte. Vetëtimat çanin me nervozizëm herë pas here qiellin.

— Nuk kemi zënë hotel. Tani sa erdhëm — u përgjigj plaka, e cila deri në atë kohë pothuajse s'kishte folur fare.

Roja puliti sytë si për të na vënë re më mirë.

— Nga vini? — na pyeti

— Nga Balldreni i Lezhës — iu përgjigja.

— S'e kam dëgjuar ndonjëherë këtë fshat — tha roja. — T'u them të drejtën nuk kam qenë

ndonjëherë në Lezhë — shtoi ai pastaj, si për t'u justifikuar meqë s'e kishte dëgjuar ndonjëherë emrin e fshatit tonë. Pastaj ai na ftoi në dhomën e tij. Një mangall i vogël, ku ndrisnin thëngjijtë e vegjël, ngrohte dhomën. Shoferi u largua duke na uruar natën e mirë.

— Ç'e mirë u ka prurë këtu? — pyeti roja pasi u ulëm: unë në një stol ndanë mangallit, ndërsa plaka në krevat.

— Kisha ca punë, — iu përgjigja.

Përrjashta binte shi. Kështu binte edhe atë natë në vitet e para të çlirimit. Shi me vetëtima. Ndanë mureve të shtëpisë kishte mbërritur uji. Vetëtima dhe shi. Pastaj pushkë. Po, po pushkë. Krismat e tyre përziheshin me ato të vetëtimave. Midis rrebeshit të motit, të thirrura njerëzish. Ato nuk dihej se nga vinin. Vetëm se ulërimat ishin rrënoqethëse. U zgjova nga gjumi dhe rrëmbeva pushkën. Gruaja flinte. Fëmijët gjithashtu. Ibrahim, që shtrihej pranë meje, me ndjeu kur u çova. Edhe ai brofi në këmbë. I thashë që të shtrihej. Përrjashta gjëmonte. Krismat e pushkëve dhe ato të rrufeve prishnin qetësinë. Nuk isha në gjendje t'i dalloja. Vetëm një vesh i stërvitur mund t'i dallonte mirë dhe të orientohej nëpër atë natë të errët. Ibrahim u shtri. Unë dola tek dera. Pa hedhur akoma një këmbë tej pragut, dëgjova një zë:

— Baba, baba — Ishte zëri i djalit. U ktheva prapa.

— Futu brenda — i thashë.

— Po ku do të shkosh?

— A nuk i dëgjon pushkët? Mund të kenë ardhur kriminelët.



— Cilët? — më pyeti ai dhe më vështroi me habi.

— Ata që duan të vrasin mësuesit, komunistët. . . .

— Po, kthehu shpejt, baba!

— Po! — i thashë dhe ika nëpër shi. Gjithë natën vazhdoi përpjekja. Kriminelët u vranë. Ata ishin pesë. Të nesërmen në sheshin e shkollës Ibrahimimi i pa ata dhe m'u afrua.

— Këta qëllonin mbrëmë? — më pyeti.

— Po! — iu përgjigja.

— Po kush i vrau? — më pyeti, — ti?

— Sigurimi bashkë me ne, — iu përgjigja.

Qysh nga ajo ditë Ibrahimimi më pyeste vazhdimisht për kriminelët. Më pyeste dhe më thoshte se edhe ai do të luftonte. Unë i përgjigjesha se kur të rritej do të luftonte kundër tyre, në qoftë se do të kishte të tillë deri atëhere. Bile edhe kur u nis ushtar në kufi ia kujtova këtë gjë. Atëhere ai ishte rritur, bërë goxha burrë. Qeshi dhe më puthi. Kur hipi në makinë më tha:

— Nëpër natë do t'i dalloj krismat e pushkëve.

Kisha besim te djali, tek pushka e tij...

— Po pse udhëtuat natën? — Ishte roja i hotelit që pyeste, — sonte është kohë e keqe. Ka disa ditë që bie shi. — Pas këtyre fjalëve ai trazoi prushin në mangall. Plaka nuk fliste.

— Do të takojmë djalin, e kemi ushtar — i thashë unë.

— Ku? — më pyeti.

— Në kufi!

— Do të udhëtoni prapë nesër? — më tha.

— Jo! — iu përgjigja — është në spital. Është pak pa qejf.

— Aha!...

— Ç'farë? — i thashë.

— Jo, jo, asgjë — tha roja.

«Ata matanë kufirit nuk rrinë rehat. Prapë kishte përpjekje. Andej nga Nikolica janë vrrarë disa shkelës kufiri. Donin të hynin në tokën tonë, por djemtë tanë i bënë kërmë. Djemtë tanë! Ky plaku sapo më tha se djalin e ka të sëmurë. Veç kësaj ai i shërben në kufi. Ta pyes se në ç'postë i shërben? Jo, jo! Mos i është plagosur? Ai nuk di gjë të saktë? Edhe unë e kam djalin ushtar. E kuptoj dhembshurinë e prindit. Sidoqoftë plaku qëndroka mirë, ndërsa ajo sikur është tronditur pak. Eh, fëmijët! Vallë, e dinë ata sa merakoset prindi për ta? Bijtë tanë janë aq të mirë, aq trima, aq besnikë të Partisë. Nuk e di mirë si është puna e djalit të këtij shokut nga Lezha, por mesiguri ai e ka nderuar. Duhet t'i hedh qymyr mangallit, plaka siç duket ka të ftohtë...», mendonte roja i hotelit ndërsa vështronte Delion.

Dezhurni i spitalit na e hapi menjëherë derën dhe na shikoi me admirim. Plaka qante nën zë. «Mos qaj, plakë» i thashë. Ajo nuk më dëgjonte. Unë akoma nuk dija se pse ishte shtruar në spital Ibrahim. Ndofta ishte plagosur, ndofta ishte sëmurur krejt rastësisht. Sidoqoftë ai vështrim plot admirim i dezhurnit tek dera e spitalit sikur më ngrohu pak. Djali që shërbente në kufi duhej të ishte kufitar, e për mua ai ishte trim, trim deri në hero. Po djali im, vallë, a e meritonte një titull të tillë? Në damarët e tij rridhte gjaku i stërgjyshërve, i familjes së tij, që tërë jetën pushkën e



kisnin pasur zanat. Por unë isha prind e ndofta kjo mund të ishte një dëshirë e imja e asgjë tjetër. Asgjë tjetër?! Po atëhere, ku duhej të shkoja? Ho-dha sytë nga plaka. Ajo kishte pushuar së qari. Nëna, megjithëse është kurdoherë nënë, përsëri në çaste të tilla di ta mbajë veten... Po ecnim në një rrugicë. Në të dy anët e saj kishte lule. Përballë po vinte një oficer. Ai qëndroi pak në vend, na hodhi një vështrim të shpejtë dhe na pyeti:

— Prindërit e Ibrahimit? — Plaka qëndroi në vend, Unë ula kokën. Ndofta këtu provova çastin më të vështirë të jetës sime. Nuk dëgjova fare. Ç'po thoshte ai?

Nëpër një marramendje të përgjithshme dëgjo-va fjalë të shkëputura «... është më mirë», «i ka rrjedhur pak gjak, por do t'i pushojë» «... luftoi si trim». (Këtu rrokullisja e mendimeve iu ndërpre. U ndërpre dhe qëndroi fort. I ngjante kjo asaj rrokullisjeje të shpejtë të ortakut të fuqishëm që papritur has në një pengesë akoma më të fuqishme e qëndron i lartë, i lartë gjer në madhështi. Ja pengesa, e fortë sa s'ka ku të shkojë më, shtylla ku ngëcin të gjitha rrebeshet e vjetra). «Trim». Ibrahim i kishte qëndruar si trim. Ngrita kokën lart.

Oficeri po më shikonte me habi. Plaka më vështronte me ca sy të ndritshëm.

— Si janë shokët, mirë, të fortë? — Oficeri sikur u shkund nga pyetja ime. Si duket kisha folur me zë të lartë.

— Mirë. Shëndoshë. Të gjithë pothuajse kanë ardhur të shikojnë Ibrahimin.

— Trimat e babait!

Oficeri më përqafoi fort. Në qafë i vura re

një gërvishtje të vogël. Ajo ishte e freskët. «Gërvishtje plumbi», mendova. Po ku, në ç'rrethanë? Tek e shtërngoja më dukej se ndjeja erën e barutit. (Me siguri beteja kishte pasur atë fillim të zakonshëm, që në pamje të parë të duket monotone. Një e dhënë për lëvizje të dyshimta, përforcime, pastaj krisma e parë... Fillimi ndofta më tronditës. Të gjithë këta që japin të dhëna, që përforcohen, që qëllojnë janë një pjesëz e dramës së madhe që luhet, ku nga çasti në çast të kërcënon vdekja. Jo, aty luhet drama ku çdo akt ka atë tension të madh që shndërrohet në gëzim. Dhe ky është gëzimi i fitores. Oficeri me shenjat e plumbit në qafë kujtonte: «Një e dhënë. Matanë ka lëvizje. Pritet një bandë. Ajo kishte hyrë dhe herë të tjera, por me dredhi kishte shpëtuar. Në kufi erdhën përforcime. I ngritëm pritën. Në një pritë pesë vetë. Së pari banda u duk tek Ura e... Pse? Donin të kalonin kufirin. Por pritën ishin ngritur. Ato ishin me nga pesë kufitarë. E në njërin prej tyre Ibrahimimi. Nata ishte e qetë. Nuk kishte hënë, por as shi nuk binte. Ibrahimimi ishte i qetë. Nuk ishte hera e parë që merrte pjesë në luftime. 20 shtator i vitit 1957. Në ditarin e postës kufitare kjo datë zuri më shumë vend se të tjerat... Pritat afër Urës së... janë ngritur. Diversantët po vijnë. Pritat, e në njërin nga ato Ibrahimimi. Fëmijëria i kishte lënë në kujtesë një natë me shi dhe vetëtima. Trazuar me vetëtimat krismat e pushkëve. Midis krislave babai me armë në dorë duke luftuar kundër kriminelëve. Po sot a do të ketë krisma? Tani për tani ato s'kanë filluar. Por do të fillojnë. Ja, ndanë pritës së Ibrahimimit ndihet zhurmë. Diversantët janë afruar, ndërsa Ibrahimimi mendon: «Vallë a i kanë parë sho-



kët e tjerë? Duhet lajmëruar. Ata nuk janë më shumë se pesë-gjashtë metra larg. Ndofta i kanë dëgjuar? Po në qoftë se jo? Jo, jo, ata duhet lajmëruar. Sinjal nuk mund t'u jap»...

Dhe filloi të lëvizë... Hapi i parë... Krismë... Ja, më në fund ajo erdhi, e befasishme, e thatë, e mbështjellë në lëvozhgën e së papriturës. Pastaj pushkët, sikur dikush u dha alarmin luftarak, u zgjuan dhe qëlluan. Luftë, luftë e vërtetë. Krisma të fuqishme tek Ura e... Ibrahimisihte i pari që u qëllua. Plumbi i ardhur nga errësira e goditi rëndë. Megjithatë ai qëllonte mbi ata që u dukën fillimisht tek kjo urë. Qëllonte ai, qëllonin shokët... Të nesërmen Ibrahimisihte kërkonte ata, shokët, nëpër gjumë, larg fushës së përpjekjes, në spital, i mbështjellë me fasha të bardha. Ngeli larg Ura e..., ngelën aty edhe diversantët e vrarë.. Këto do t'ia thotë vetë Ibrahimisihte të jatit», mendonte oficeri me gërvishtjen e plumbit në qafë tek shoqëronte Delin, të jatin e Ibrahim Dushkut, për në pavion.

..Plaga që kishte marrë djali ishte tepër e rëndë. Me gjithë kujdesin e jashtëzakonshëm të personelit të spitalit, gjaku nuk i pushoi për asnjë çast. Ai rridhte papushim duke skuqur fashat e bardha, çarçafët... sytë e së jëmës, të miat, të shokëve që i qëndruan pranë. Ishte ndofta një kujdes si ndaj vëllait. Pas disa ditësh ai vdiq. Si më tha kur u takova herën e parë? Ah, po! «I dallova mirë krismat e pushkëve, të shokëve, të armiqve. Megjithëse nuk binte shi dhe vetëtima nuk kishte, ajo natë ishte një rrebesh i vërtetë. Krismat e armëve të shokëve nuk më largohen nga veshët edhe

tani. Ata janë në kufi e ruajnë, ndofta luftojnë, ndërsa mua më buçasin në veshë të fuqishme fjalët e tyre aq të dhimbshme: «Na e vranë Ibrahimin...» Unë do të shërohem e do të shkoj pranë tyre...

Isha i rrethuar nga kufitarët. Të gjithë djem të rinj, moshatarë me djalin tim. M'u afrua oficeri, komandanti i tyre, dhe më tha:

— Ibrahim i është djali ynë. Kemi një kërkesë: ta varrosim ndanë postët së kufirit.

Kjo, për djalin tim, ishte një nder i madh. Edhe për mua gjithashtu. Por edhe unë si babë kisha një dëshirë: ta merrja me vete, ta varrosja pranë tokës ku eci me vite të tëra; pranë tokës dikur moçal me mushkonja, që tani pas Çlirimit është bërë një fushë e mbjellë dhe e bukur si nuse. Kërkesën time oficeri e pranoi dhe shtoi:

— Mirë, atëhere, por djalin do të ta sjellim në në shtëpi.

U nisëm për rrugë. Dy makina përpinin kilometrat e shumtë. Një makinë ishte plot me shokë të Ibrahimit. Në makinën e parë isha unë me plakën dhe oficerin. Plaka vështronte herë pas here makinën prapa, plot me kufitarë. Do t'i ngelej në kujtesë kjo pamje. Edhe më vonë, sa herë shikonte makina me ushtarë qëndronte ndanë xhadesë e i vështronte me dhëshuri. Nga dashuria e nënës i takon cilitdo kufitari. Por Ibrahimit i dhanë të gjithë nga dashuria e tyre dhe kjo ishte më e madhe se e çdo nëne. Ai hyri në atë zemër të fuqishme që rreh në gjoksin e popullit tim.





## ATË DITË QË BËHEJ BETIMI

*Kushtuar dëshmorit Refat Teta*

...Pastaj ne dolëm në xhade. Kishim ecur rrugë e pa rrugë afro një orë. Shokun tonë e mbanim në krah. Nga plaga i rridhte gjak. Ne e shikonim atë me dhembje. Në rrugë kalonin pak makina. Ato ishin të rralla. Kishim afro një çerek ore që pris-

nim ndanë rrugës dhe asnjë makinë nuk kishte kaluar. Rruga gjarpëronte midis grykave. Po të kalonte ndonjë, ne e dallonim atë që larg. Ishte korrik. Pluhuri i mbushte rrugët dhe barin që rrethonte të dy anët e saj. Buzët na ishin tharë për ujë. Ujë! Edhe shoku ynë i plagosur kërkonte ujë. Po ai nuk duhej të pinte. Nga uji na pat vdekur dikur një shoku ynë në luftë. U plagos dhe kërkonte ujë. Ne atëhere ishim në një mal të lartë. Atëhere i plagosuri mbushi duart me dëborë dhe i futi në gojë. Pas pak ai vdiq. Por shoku ynë tani nuk duhej të pinte ujë, megjithëse na therte në zemër kur e dëgjonim që thoshte «ujë, ujë...» Atë ditë ishte 26 korriku i vitit 1946. Njësitë doli i tëri aty ndanë rrugës. Na ishte plagosur rëndë shoku ynë. Atë e quanin Refat.

Kaloi dhe një orë kur nga larg u dukën re të bardha pluhuri. Dielli ishte në të perënduar. Reja sa vinte e zmadhohej. Në të vërtetë, ajo afrohej, e në sytë tanë krijohet iluzioni i madhësisë Pluhuri i bardhë na qetësoi. Me siguri kalonte ndonjë makinë. Nuk kaloi shumë kohë dhe ajo u afrua pranë nesh. Shoferi ndaloi. I treguam shokut tonë të plagosur. Ai na i bëri shenjë që të hipnim në kabinë, por ne u ngjitëm lart në karroceri. Kabina ishte e vogël, e shoku ynë nuk mund të mblidhej kruspull. Plaga ishte e rëndë. Mbi karroceri hipi i tërë njësitë. Hoqëm xhaketat tona e i shtruam. Refati rrinte i shtrirë në mes të karrocërisë, ndërsa ne anash tij. Kur makina u nis, Refati mundi të belbëzonte disa fjalë pa kuptim.

Ne ngulëm sytë në sytë e tij. Ato u hapën. Dy sy të zinj e të ndritshëm. Ata shkëlqenin. Një shoku ynë iu afrua, i ngriti kokën dhe i tha:



— Mos u lodh, mos fol, ja edhe pak do të arrijmë në spital.

Refati bëri me shenjë, si t'u merrte leje shoqëve për të folur, dhe tha:

— Nuk u lë amanet as babën, as nënën, as vëllanë, as motrën, as djalin e vogël e as gruan. Kam vetëm këtë: Betohuni edhe për mua.

Kaq tha dhe mbylli sytë përgjithmonë Refat Teta, ushtar i forcave të ndjekjes, në divizionin e mbrojtjes së popullit.

Për çfarë betimi bënte fjalë ai?

\*

\* \*

Njësitë ynë ishte lajmëruar se me datën 26 korrik do të mbledheshim në qytetin P, pasi do të bëhej betimi ushtarak. Atë ditë ne rrinim në oborrin e shkollës së fshatit. Pranë meje ishte edhe Refati. Me të kisha kohë që njihesha. Pastronim armët. Ishte gdhirë. Dielli akoma nuk kishte dalë. Frynte një fllad i freskët. Pasi përfunduam përgatitjet u nisëm për rrugë. Duhej të shkonim me këmbë deri në qytet. Vendosëm të kalonim në rrugën më të shkurtër. Ajo kalonte midis pyjesh të dendura. Atë rrugë na e rekomandoi Refati. Ai ishte nga ato anë dhe e njihte mirë vendin. Lamë prapa fshatin dhe, kur ngjitëm të përpjetën e parë, në kodrat që ngriheshin aty rrotull, dielli nxori kokën midis dy majave të larta, që rrinin krah njëra-tjetrës. Të gjithë anëtarët e njësitit ecnin varg. Pranë meje ecte Refati. Dukej i menduar. Ç'të mendonte vallë? Nënën, babën, vëllanë?.. Pas pak u futëm në pyll. Ndofta Refati kujtonte djalin e vetëm në shtëpi.

Ai me siguri ishte rritur... Po a do ta njihte babën kur të vinte në shtëpi? Pylli ishte plot me drurë të lartë, të cilët nuk lejonin depërtimin e rrezeve të diellit. Qëndruam pak. Në pyll ishte fresk. Përsëri filluam të ecnim. Pa ecur as një çerek ore një krismë pushke na bëri që të ndalonim të gjithë njëherësh. Refati më vështroi drejt në sy. Dukej sikur më pyeste «ç'ndodhi?..» Por koha s'priste. Atëhere, sikur ta kishim kuptuar vetëm me një shikim njëri-tjetrit, shumë pozicione me shpejtësi. Po kështu veproi i gjithë njësitit. Pa kaluar as dhjetë sekonda pylli oshëtiu nga krismat e pushkëve. Një grup banditësh qëllonin drejt nesh. Ishte një kor krismash të çrregullta. Herë-herë dëgjoheshin krisma të vetëmuara. Ishte mëngjes dhe ata ndofta po flinin akoma. Roja i tyre siç duket na pa dhe qëlloi i pari. Atëhere banditët e tjerë u çuan me të shpejtë dhe filluan të qëllojnë drejt nesh. Kjo për ne ishte e papritur. Nuk e mendonim kurrë se në afërsi të fshatit ku qëndronim ne kishte dhe një bandë armiqsh. Sidoqoftë njësitit u orientua. Në këto çaste lufta ishte shumë e shpejtë. Manovrimet e njësitit tonë ishin kaq të zhdërvjellta sa banditët u çoroditën. Mundëm të kapnim të gjallë dy prej tyre. Nga ana jonë s'pati asnjë të vrarë, bile edhe asnjë të plagosur. Dy robërit i muarëm në pyetje. Nuk tregonin asgjë. Kjo ishte një hetuesi në mal. A e dini se ç'do të thotë kjo? Është një hetuesi masive, e shpejtë. Dialogjet janë shumë dramatike. Në pak sekonda rrokullisen me rropame ngjarje, emra njerëzish, vendesh, data, krime. Po, po, krime. Ata ishin banditë dhe zanati i tyre ishte krimi. Sekondi i humbur është shumë i vlefshëm. Prandaj ne pyesnim të tërë. Ne na mundonte ve-



tëm një gjë, dhe pyetjet tona ishin breshëri. Banditi përgjigjej. Përgjigjej, por herë-herë mundohej edhe të dredhonte. Por, kur i kërcënohej ekzistenca, fliste. A e dini se banditit i dhimbset shumë jeta? Krimineli vret ç't'i dalë përpara. Dhe kjo nuk është trimëri...

Në rolin e hetuesit ishim ne, anëtarët e njësitit. Dhe njëri bandit u thye. Kjo na solli shumë të mira. Ramë në gjurmë të një bande që kishim kohë që e kërkonim. Banda ishte e përbërë prej katër vetësh dhe udhëhiqej nga një bandit shumë i rrezikshëm që do ta quajmë «Mili».

Por «Mili» ishte strehuar shumë larg nga pylli ku ishim ne. Duhej të udhëtonim rreth tri orë. Veç kësaj urdhrin e kishim për të shkuar në qytet. Atë ditë do të bëhej betimi. Si duhej të vepronim? Komandanti i njësitit tha:

— Betimi më i mirë i yni ndaj Partisë është të asgjësojmë bandën e «Milit». Të nisemi te vendi ku është strehuar «Mili».

Po nga duhej të kalonim? Përsëri propozoi Refati. Ai i dinte mirë rrugët. Ishte rritur në ato anë. Kushedi sa herë kishte kaluar në fëmijëri, ashtu i zbathur e i uritur, pas atyre pak bagëtive. Kishte ecur ai me varfërinë e tij këtyre pyjeve, e bashkë me lotët e dhembjeve, kur shpohej nga ferrat, kapërdinte lotët e urisë. A e dini se ç'janë lotët e urisë? Është një rrokullim uji i hidhur, farmak që të djeg fytin e të vjen të bërtasësh, ta ngresh zërin në kupë të qiellit. Po kujt t'i drejtohej Refati në fëmijërinë e tij, zotit? Ai s'dëgjonte. Agait? Edhe ai s'dëgjonte. Po atëhere kujt? Dhe ajo ditë erdhi; takoi njerzit që e dëgjuan, e kuptuan dhe e morën me vete. Ja, sot, ai atyre po u tregonte rrugën

për të shkuar në vendin ku ishte strehuar «Mili», agai që nuk dëgjonte të bërtiturat e Refatit të vogël... U nisëm. Me vete morëm dhe dy banditët që kishim zënë rob. Do ta paguanin shtrenjtë në qoftë se na gënjenin. Ata na kishin thënë se «Mili» ishte plagosur dhe ishte strehuar në shtëpinë e një farë Rexhep T.

Dhe ecnim varg njëri pas tjetrit. Drejtimi ynë tani ndryshoi. Muarëm masa që të mos binim në ndonjë të papritur. Ritmi i ecjes sonë ishte i lartë. Dielli na digjte mbi kokë. Ishte vapë. Djersa na dilte mbi rrobe.

Rrugës kaluam shumë përrenj. Ata sikur na çlodhnin. Nuk bëmë asnjë pushim. Të gjithë anëtarët e njësitit mendonin për bandën e «Milit». Mendimi se do të zhdukej edhe një armik i rrezikshëm na i shtonte forcat. Veç kësaj asgjësimi i tyre do të ishte betimi më i mirë para popullit.

Më në fund u afruam afër fshatit. Frymëmarrja jonë i ngjante një furshullime. Aty u çlodhëm pak. Shtëpia e Rexhep T. ishte në qendër të fshatit. Qendër i thoshnin, por shtëpitë ishin të shpërndara, larg, shumë larg njëra-tjetrës, me fshehtësinë më të madhe rrethuan shtëpinë. Nuk dinim gjë nëse kishim rënë në sy të kriminelëve, që ishin fshehur aty brenda. Po sidoqoftë ishim të pregatitur edhe për një përleshje të afërt. Ata s'duhej të na shpëtonin.

Pasi u muarën masa të forta rrethimi, u drejtuan nga shtëpia e thërritëm të zotin e shtëpisë. Na u përgjigj një zë gruaje. Kur na pa të armatosur, u fut menjëherë brenda. Pas pak doli i shoqi, Rexhepi. Ishte një malësor tipik. I gjatë e me mustaqe të gjata. Në gojë mbante një lullë. Edhe kur u afrua



pranë nesh e na zgjati dorën, ai nuk e hoqi llullën nga goja.

— A mbahesh, Rexhep? — e pyeta.

— I fortë, besa! — u përgjigj; nxori një shtëllungë tymi e na e drejtoi në fytyrë. Ishte një qëndrim prej kapadaiu. E mbajtëm veten.

— Do të vish pak me ne — i thamë.

— Ku? — u përgjigj. Llullën e hoqi nga goja. Sytë e tij shprehën habi.

— Të dalim jashtë oborrit, — iu përgjigja. Refati kishte qëndruar aty afër.

Dolëm nga oborri. Nuk duhej humbur kohë. Dhe ne filluam nga pyetjet. Plaku nuk përgjigjej. Ai madje pretendonte se «Milin» as që e njihnte fare. I thamë se do të bënim kontroll. Ai pranoi menjëherë. Sidoqoftë ne mund ta ballafaqonim me dy kriminelët e arrestuar, të cilët i kishim me vete. Por kontrollin vendosëm ta bëjmë. Shtëpia ishte dy katëshe. Kontrolluam imtësisht. Asgjë. Përveç të zotëve të shtëpisë asnjë njeri tjetër dhe, asnjë gjurmë për të dyshuar. Mos vallë krimineli rob na pat gënjyer? Atëhere e muarëm prapë kriminelin në pyetje. Ai ngulte këmbë në të tijën, madje kërkoi edhe ballafaqim me Rexhepin, të zotin e shtëpisë. Atëhere duhej ta ballafaqonim. Rexhepi, kur pa kriminelin e arrestuar, kuptoi se ai na kishte treguar. Ai tha vetëm këto fjalë:

— «Milin» e keni brenda.

— Thuajti të dalë — i thashë.

— Pa luftë ai nuk dorëzohet — u përgjigj plaku.

— Ku është fshehur? — e pyeta.

— Nën shtëpi është një tunel. Kur ju pa juve ai u fsheh brenda, është i plagosur.

— Po tre të tjerët ku janë? — e pyeta.

Rexhepi tha se janë fshehur diku prapa shtëpisë. Por ne duhej të fillonim nga «Mili». Si të vëpronim që atë ta kapnim të gjallë? Duhej ta bindnim Rexhepin që të na ndihmonte. Po një fjalë goje ishte kjo. Me atë plak kaluam çaste tensioni të madh.

Plaku, Rexhepi, u fut brenda në shtëpi. Ne prisnim jashtë. Vendi ishte i rrethuar. Pas pak nga shtëpia doli një grua. Ajo kishte mbuluar kokën me shami e ecte me hap të nxituar. Në të dalë të derës së oborrit dy ushtarë iu afruan. Ajo qëndroi. Ushtarët iu hodhën sipër dhe në mënyrë të rrufeshme i lidhën duart. I hoqën shaminë nga koka.

— E more «Mil» — i thashë — ku vajti burrëria jote?

Ai na pa me ca sy të egër. Turfulloi njëherë tërë inat dhe uli kokën. E çarmatosëm.

«Mili» i kish dëgjuar porositë e Rexhepit për t'u veshur si grua. Rexhepin e kishim porositur ne. Deri këtu çdo gjë vajti mirë. Duheshin arrestuar ose vrarë tre të tjerët.

Forcat e ngushtuan rrethimin. Nga mesi i arës me misër u dëgjua një krismë. Pas saj të tjera. Kriminelët filluan të qëllojnë. Ara me misër ishte e madhe. Nga vendi i ngritur, ku qëndronim ne, ajo dukej si një det i gjelbër. Në të nuk dallohej asgjë. Frynte një puhizë e lehtë. Kriminelët e shfeshhur i dallonim nga krismat që lëshonin armët e tyre dhe nga përkundja e fuqishme e rrënjëve të misrit ku ata kalonin. Në pak çaste Refati m'u largua nga sytë. Ai iu afrua banditëve më afër se të tjerët. Banditët i kishte jo më shumë se tri-dhjetë metra. Ai nuk qëllonte. Pse? Prisnim me




ankth. Ç'po ndodhte me të? Mos i ishte bllokuar arma? Kaloi një sekondë... dy... tre...

— Refat! — i thërrita. Në vend të përgjigjes dëgjova një krismë të fuqishme bombe. Pastaj një re pluhuri mbuloi gjithshka. Në pak sekonda u dëgjuan disa krisma të thata e të vetëmuara maliheri. Reja e pluhurit po ulej dalngadalë. Krismat po fashiteshin. Refatin s'po e shikoja më. Filluam të afroheshim.

— Jam këtu, këtu... — dëgjuam një zë të mbytur. Pesë-gjashtë metra afër nesh, pamë Refatin të shtrirë. Ishte zverdhur në fytyrë. Në dorën e djathtë mbante armën, ndërsa të majtën e kishte vendosur në anën e majtë të barkut ku ishte plagosur. Dora i ishte mbuluar me gjak. Plaga që kishte marrë ishte e rëndë. Të tre banditët ishin vrrarë. Morëm në krah shokun tonë dhe u nisëm në drejtim të qytetit P. Ndonjëri nga ne nuk i përmbajti dot lotët. E donim atë njeri. Kishim luftuar për të njëjtin ideal, në të njëjtat llogore, kundër të njëjtit armik.

Duhej të nxitonim, për të dalë në rrugë, ku mund të kalonte ndonjë makinë...



## SHTEGTIMI I FUNDIT

Posta kufitare e shtetit fqinj atë ditë korriku kishte një pamje jo të zakonshme. Vrojtuesi i postës sonë kufitare nuk i hiqte sytë nga një grup njerëzish që vështronin të interesuar token tonë. Dielli nuk kishte dalë akoma dhe një fllad i lehtë ia përkëdhelte fytyrën kufitarit vrojtues. Atij peisazhi i bukur përreth nuk i bënte përshtypje; shushurima e gjetheve të pyllit, bari i njomë, ciçërima e zogjve dhe zilet e bagëtive të fshatit aty afër, nuk i tërhiqnin vëmendjen. Ai kishte ngrirë



i tëri në vendin e vrojtimit dhe nuk i hiqte sytë nga ai grumbull njerëzish matanë kufirit, që vështronin pa pushim në tokën tonë, lëviznin nga vendi, zinin këndvështrim më të përshtatshëm dhe përsëri vrojtonin. «Ata diçka kanë. Jo pa qëllim veprojnë ashtu», mendoj kufitari.

Kjo gjë vazhdoi, nga 12 deri në 14 korrik. . .

Punëtori operativ i zonës, Aleks S, vjeç 28, i biri i një dëshmori të Luftës Nacionalçlirimtare, zgjidhi edhe një problem të vogël me 14 korrik, mbasi të nesërmen do të kthehej në qytet. Në datën 17 korrik, ditën e diel, do të festohej 25-vjetori i formimit të brigadës partizane ku kishte qenë edhe i jati. Vendi i formimit të brigadës ishte aty afër fshatit kufitar, në një shesh të vogël të rrethuar me drurë të lartë. Ai duhej të kthehej në shtëpi, të ndërronte rrobat dhe në datën 18 të rreshtohej me shokët e babait, të cilët e njihnin, e donin dhe e respektonin. Ai kishte shkuar dhe në 20 vjetorin dhe mezi priste t'i takonte përsëri ata shokë të mirë e të dashur që kishin kaluar kushedi sa herë pranë vdekjes por me një trimëri të rrallë e kishin sfiduar atë. «Të sfidosh vdekjen është me të vërtetë trimëri», mendoj Aleks i atë mëngjes të 15 korrikut. Pa hyrë akoma në klubin e fshatit një korrier e lajmëroi se e kërkonin me urgjencë në postën kufitare. «Diçka duhet të ketë ndodhur», tha ai me vete dhe u kthye me të shpejtë. «Mos ka gjë lidhje me atë grumbull njerëzish kuriozë matanë kufirit?» mendonte Aleks duke ecur dhe herë pas here vështronte tutje në horizont postën kufitare.

Grupi operativ mbërriti në postë rreth gjysmë

ore para se të vinte aty Aleksî. Ata shkuan menjëherë aty ku dalloheshin qartë gjurmët, afër vijës së kufirit. Në vështrim të parë dalloheshin gjurmët e dy vetave.

— Atëhere janë dy. Kalesa është nga jashtë brenda, — tha një anëtar i grupit operativ. Eksperti akoma nuk kishte folur. Ai ishte përqëndruar i tëri në një aparat të vogël dhe diç maste në një-rën gjurmë.

— Nuk janë dy, por tre, — tha ai pa ngritur kokën. Në këtë kohë mbërriti dhe Aleksî, i cili vetëm sa i përshëndeti shokët dhe kërkoi të sqarohej nga komandanti i postës.

— Me siguri kanë kaluar tre, — tha përsëri eksperti, — kjo duket qartë nga thellësia e gjurmës. Është një manevër e përdorur edhe herë të tjera.

Aleksî dëgjonte me vëmendje. Ai dalngadalë po futej në vorbullën e ngjarjes dhe për asnjë çast nuk i hiqej nga mendja sinjalizimi i atij kufitarit vrojtues për lëvizjet e një grumbulli njerëzish matanë kufirit për tri ditë rresht.

«Pra ata kanë kaluar natën dhe tani diku janë futur. Veç kësaj për çdo të papritur të tretin duan ta mbajnë në heshtje. Ai duhet të ketë dhe misionin kryesor».

Grupi operativ po kthehej, kur Aleksit i shkrepëtiti një mendim. «Mos vallë kjo ka lidhje me festën që do të bëhet pasnesër», mendoi ai dhe mornica të ftohta ia përshkruan trupin. Si nëpër mjegulliu shfaqën shokët e të jatit, me shami të kuqe në qafë, me grushtin lart, duke parakaluar. Thinjat e tyre, plagët në trup, ai qëndrim krenar dhe i thjeshtë njëkohësisht, i përfytyroheshin të vëna në shënjestër,



Nga kush? Tre njerëz me fytyra të deformatuara, të mbuluar nga një tis mjegulle, duke skërmitur dhëmbët merrnin në shenjë... «Jo, kjo nuk duhet të ndodhë kurrë, kurrë!», tha me vete Aleksis.

Natë. Tre njerëz, pa folur, ecnin dhe vështronin përreth. Nuk dukej asgjë, veçse tek-tuk, në të dy anët e luginës, ndrisnin disa drita. Nata ishte me yje dhe atij që s'e njihte vendin këto drita do t'i dukeshin si yje të montuara në horizont, i cili ishte shkrirë sa nuk mund të dalloje ku kishte hapësirë e ku mal. Ata ecnin me shpejtësi, aq sa u ndjehej frymëmarrja. Ai që ecte i pari tha:

— Kristaq, edhe sa do të ecim?

Ai që vinte i fundit, që me sa dukej quhej Kristaq, u përgjigj:

— Edhe njëzet minuta; po ecni, ecni.

Më tutje asnjë fjalë. Veçse kur në rrugën automobilistike u dëgjua një zhurmë makine ata qëndruan në vend.

— Po kjo ç'të jetë vallë? — Tani ai që pyeti ishte Kristaqi. Asnjë nuk iu përgjigj. Të tre ishin struktur dhe dëgjonin zhurmën e makinës, që sa vinte e afrohej.

— Mos jemi afër rrugës? — pyeti ai që ishte në mes të Kristaqit dhe atij që udhëhiqte rrugën.

— Jo, — u përgjigj Kristaqi.

Makina tani ishte në pikën më të afërt të tyre. Dritat e fuqishme të saj përshkuan monopatin dhe ata, vetëm për një çast, panë mirë vendin rreth e rrotull. Makina iku larg dhe zhurma e motorit filloi të dobësohej.

— Nisemi, — tha Kristaqi. Nga toni i të folurit mund të dalloje se ky ishte shefi i këtyre njerëzve, që ecnin nëpër natë, në drejtim të shtëpisë më të veçuar të atij fshati malor. Një qen filloi të lehë.

— Po afrohemi, — tha Kristaqi.

Të tre qëndruan përsëri. Kësaj radhe nuk foli asnjëri. Kristaqi diçka mendonte dhe shikonte herë në herë tjetrin. Pastaj, sikur të ishte kujtuar për diçka të rëndësishme, urdhëroi Simonin:

— Në shtëpi do të shkosh ti. — Toni i tij ishte i prerë.

— Përse nuk flet? — pyeti Kristaqi, kur e pa se Simoni nuk po e hapte gojën, dhe vazhdoi: — Nisu! Për çdo të papritur takohemi prapa «Harcës së ILQE», më kupton?

— Po, — tha ai që quhej Simon, — të kuptoj. Qeni filloi të lehë përsëri. Më tutje nga grumbulli i shtëpive afër fshatit, si në kor, filluan të lehnin qentë e tjerë.

— Në një farë mase, qentë janë sinjalizuesit më besnikë, — vazhdoi Simoni.

— Gjete kohën të filozofosh, — ironizoi Kristaqi. Pastaj shtoi: — Ky është panik. Puna jonë nuk e pranon frikën. Ç'do të thuash ti, Simon, me aua sinjalizues? Mos do të thuash që të kthehemi?!

Simoni nuk foli më asnjë fjalë. E kuptoi se bëri gabim, sepse, kur i krahasoi qentë me sinjalizuesit, i dha rastin Kristaqit që ta kritikonte përsëri.

— Atëhere ti Simon e ke të qartë? — urdhëroi Kristaqi pas një heshtjeje të shkurtër.

— Po — tha Simoni dhe u nis. Qeni filloi të lehë përsëri. Kristaqi me Petron zunë një vend të



mirë prapa një guri të madh. ndërsa Simoni u afrua dhe trokiti te dera e shtëpisë ku e patën urdhëruar.

Pas 10 minutash të tre ata ishin brenda në shtëpi. Atje gjetën një grua dhe vajzën e saj, që po flinte në një dhomë tjetër.

— Burri kur ju ka ikur? — e pyeti Kristaqi gruan. Ajo në fillim heshti, por kur sytë e saj u takuan me ato të Kristaqit, nuk e mbajti dot veten dhe u përgjigj:

— Ka shumë vjet. Më nxiu jetën, vajzën ma la në derë. Zhvillohet luftë klasash. Kush e merr të bijën e një tradhtari? Dhe kanë të drejtë sho-ku... — Gruaja i tha këto fjalë me një ton të qetë, duke psherëtitur her pas here. Ajo ia nguli sytë Kristaqit, dhe e njohu. — O perendi, — tha me vete, — sa ka ndryshuar!

— Keni letërkëmbim me të? — pyeti përsëri Kristaqi.

— Ai nuk jeton më, — tha gruaaja me rrëmbim. Sytë e saj u njomën.

Kristaqi e vuri re se gruaaja e njohu dhe, sipas planit që kishin vendosur që jashtë, tha:

— Jo. Ai jeton. Jeton dhe ty të kujton. Kujton edhe vajzën që e la në bark të nënës.

Këto fjalë i shqiptoi me një pasion të tillë, thua se edhe ai jetonte brengën e kësaj gruaje.

— As Kristaqi, as gruaaja nuk i dhanë të njohur njëri-tjetrit. Pastaj Kristaqi mori çantën, e hapi me kujdes, nxori prej andej një pako dhe ia zgjati gruas.

— Merri, — i tha, — i ke nga yt shoq. Ai të kujton dhe nuk të harron. Së shpejti do të vijë edhe

ai, vetëm sa t'ju takojë. Kam edhe një letër nga ai, edhe të holla.

Gruaja nuk fliste. Sytë i qeshnin. Petroja dhe Simoni ndiqnin me kujdes lëvizjet e gruas dhe dëgjonin çdo zhurmë që vinte nga jashtë.

— Çfarë feste bëhet këto ditë? — pyeti Kristaqaq ndonëse e dinte fort mirë.

— 25-vjetori i brigadës së krahinës. Kanë kohë që bëjnë përgatitje.

— Kur kaluan 25 vjet! E kam parasysh si dje.

Kristaqaq humbi në kujtime dhe dukej sikur po fliste me vete. Petroja, që e njihte mirë, e kuptoi se ai ishte në çastin më të vështirë të bisedës me gruan. «Ato ishin ditë të vështira — po thoshte Kristaqaq: — Ne iknim varg njëri pas tjetrit, me një hidhërim të thellë si të mundur që qemë. Në shpirt na vlonte urrejtja dhe donim të hakmerreshim, të vrisnim...» «Pastaj, si t'i qe kujtuar diçka, iu drejtua gruas dhe e pyeti: — Moj, po një farë Taqo, Taqo, jeton vallë? — megjithëse e dinte mirë se Taqoja jetonte.

— Taqo Bregu? — tha gruaja.

— Po — u përgjigj Kristaqaq.

— Jeton si nuk jeton. Dhe ia çon për mreku-lli. Është i zgjuar, finok. Ndejti sa ndejti me Ballin, hëngri sa deshi dhe kur e pa se ngjarjet u rrokullisën ndryshe, çoç hodhi dhe ai nja dy mua; dyfe-kun në krahë si partizan dhe tani...

Kristaqaq dëgjonte me vëmendje.

— Domethënë jetoka, mirë? — pyeti qëllimisht, sepse ai e dinte si jetonte Taqoja, ngaqë kishte mbajtur lidhje me të, por ndonjë detyrë konkrete nuk i kish caktuar.



— Mirë, mirë. Ndonjë funksion nuk ka, as anëtar partie nuk është, por të paktën nuk e trazon njeri «Ishte i gënjyer», thonë, dhe nuk e shikojnë me sy të keq.

— Shtëpinë e ka larg prej këtej? — pyeti Kristaqi meqenëse ishte i sigurt tek gruaja, pasi dikur ajo i kishte ndihmuar mjaft.

— Jo, — u përgjigj ajo.

Përrashta ishte qetësi. Hëna nxori synë nga gafa e malit dhe i dha një ndriçim argjendi vendit përreth.

— Po këta të tjerët nga i kemi? — pyeti gruaja.

— Këtej nga kjo krahinë, — u përgjigj Kristaqi dhe pastaj pyeti:

— Vajza po fle?

— Po — u përgjigj gruaja.

— Ta dërgojmë në shtëpinë e Taqos. Na duhet edhe ai sonte.

Gruaja në fillim heshti, pastaj tha:

— Vajza po fle. Sot është lodhur shumë? Ka punuar në aksion

— Ç'është ky aksion? — pyeti Simoni.

— Punë vullnetare. Hajde puno pa lekë! Dhe po të duash, mos shko! Të ngjisin një mijë e një nofka. Pa le të mos shkojë ndonjë nga fëmijët tanë! «I dekluar, ruan traditat e familjes», në majë të gjuhës i kanë këto fjalë. Janë bërë të gjithë politikanë.

Kristaqi qeshi. Pas tij edhe Simoni me Petron.

Gruaja thithte çdo fjalë që thoshte Kristaqi. Sytë e saj shndrisnin nën dritën e llampës.

— Si thua, do ta dërgojmë vajzën? — Kris-

taqi e ngriti zërin lart, aq sa Simonit dhe Petros nuk i shpëtuan nuancat e urdhrit në fjalët e tij.

— Po, — tha gruaja që me sa dukej e kuptoi se fjalët e Kristaqit nuk ishin një lutje e zakonshme. Simoni nuk e përmbajti dot veten kur dëgjoi të lehurat e qenit, dhe tha:

— Qeni është kafsha më interesante. E lehura e tij, veçanërisht natën, të kujton gjëmën, kujën, Është një kombinim i çuditshëm i dhembjes njerëzore, me llahtarën e një kafshe.

Simoni fliste, ndërsa Petroja vështronte në sy Kristaqin, i cili, për çudinë e tij, kësaj here nuk po ndërhynte në bisedë.

— Por — vazhdoi të fliste Simoni, — edhe qeni ka fatkeqësinë e tij. Është kafshë dhe nuk e kupton se... — por nuk e mbaroi dot fjalën, pasi Kristaqi me të qeshur i tha:

— Simon, na çmende me këto filozofime!

Simoni u largua nga dritarja dhe mbështeti kokën pas murit. Gruaja u ngrit dhe kaloi në dhomën tjetër për të zgjuar vajzën. Aty ngelën vetëm ata të tre.

Pas pak, kur heshtja sundonte dhomën, u hap dera dhe pas gruas hyri një vajzë e re, e gjatë, me tipare të rregullta, e me dy sy të mëdhenj. Ajo fërkonte sytë dhe, thujse instinktivisht, u dha dorën tre burrave, që u çuan njëri pas tjetrit.

— Kjo është vajza ime, — tha gruaja duke mos bërë asnjë lëvizje me dorë. — Ndërsa këta janë tre oficerë të Sigurimit. — Tre burrat ulën kokën në shenjë miratimi; ndërsa Simoni vuri edhe dorën tek zemra. Gruaja nuk ishte e sigurt tek vajza.

— Vajza të qenka rritur goxha, — tha Kris-



taqi. Pastaj, duke ndryshuar tonin, pyeti:

— Si quhet vajza?

— Shpresa, — u përgjigj gruaja.

Simoni kishte mbështetur kokën te automatiku dhe ëndërronte. Petroja pinte cigare. Shpresa hyri përsëri në dhomë dhe tha:

— Jam gati. Xha Taqoja duhet të vijë patjetër këtu. Po si t'i them, kush e kërkon? — Pyetja e Shpresës ishte direkte dhe Kristaqi u zu në befasi.

— Ta them përjashta, — tha Kristaqi, i cili po shkruante diçka në një copë letër. Simoni dhe Petroja po rregullonin çantat. Gruaja nuk po kuptonte gjë nga këto lëvizje dhe kishte ngrirë në mes të dhomës. Shpresa ishte bërë gati dhe priste te dera duke vështruar qiellin. Kristaqi mbaroi së shkruari letrën dhe u ngrit në këmbë. Gruaja shkoi pas Kristaqit. Tek dera ky i tha gruas që të rrinte brenda, dhe ajo u kthye.

— Nuk ke frikë të ecësh natën? — pyeti Kristaqi Shpresën, e cila sa nuk u hodh përpjete nga frika kur dëgjoji aq papritur atë zë tek veshi.

— Jo — u përgjigj ajo kur e mblodhi pak veten. — Pastaj kjo është një detyrë që më jepet nga shokët e Sigurimit, dhe unë do ta kryej sikur edhe... — ajo donte të shtonte edhe diçka tjetër, por e mbajti, se mos i dilte sheshit artificialiteti, dhe tha: — Kjo nuk është ndonjë detyrë kushedi çfarë.

— Shumë mirë, Shpresa. Tani nisu, — i tha Kristaqi.

— Si t'i them xha Taqos?

— Ah, po, se desh harrova, — tha Kristaqi, i

cili ktheu kokën dhe pa një herë rreth e rrotull se mos i kishte vënë re njeri.

— Thuaji që të pret patjetër sonte, nënkryetari i degës. Duhet të vijë patjetër. Tani nisu. Dhe në qoftë se takon njeri rrugës, asnjë fjalë. Kup-ton?

Shpresa u nis me vrap, ndërsa Kristaqi nderi një copë herë tek dera duke ndjekur siluetën e Shpresës, e cila dalngadalë po shndërrohej në një pikë. «E, si është ndërtuar kjo botë! Do të ishim ne këtu, dhe do të jetonim për mrekulli», tha me vete Kristaqi dhe u fut brenda. Simoni dhe Petroja u çuan në këmbë dhe hodhën çantat në shpinë.

— Atëhere mirë u pafshim — u tha Kristaqi dhe u zgjati dorën të dyve. Petros i dha dhe copën e letrës që shkruajti më parë. Edhe gruaja u zgjati dorën të dyve dhe u uroi udhën e mbarë. Sapo ata u larguan, Kristaqi iu afrua gruas. Kjo uli sytë dhe pështeti kokën në gjoksin e tij.

— Në fillim nuk të njoha, — tha gruaja.

— E po kaluan kaq vjet, — tha Kristaqi. — Po shtëpia e Taqos është larg?

Gruaja e kuptoi përse ia bëri këtë pyetje dhe u përgjigj:

— Jo — dhe u ul pranë tij... Ndërsa Petroja dhe Simoni ecnin nëpër natë.

— E di mirë rrugën? — pyeti Simoni.

— Po. Ec pas meje dhe fol me zë të ulët.

— Po Kristaqi ç'bën vallë tani?

— Nuk e di.

— Oh, nuk e di. Ai ngeli vetëm me gruan dhe...

— Shëëët, më duket se dëgjova zhurmë, — pëshpëriti Petroja.



Nga larg dëgjoheshin të lehurat e qenve.

— Kristaqi. . .

— Oh, edhe ti Simon! . .

— Duart lart! — u dëgjua një zë.

— Mos lëviz!

— Mos lëviz, Simon! — tha Petroja i tmerruar.

— Dhe shiko, për Kristaqin asnjë fjalë! Në kufi janë gjetur dy gjurmë. Kujto porosinë «të ruhet i treti me çdo kusht».

— Po letra e Kristaqit?

— E futa poshtë një guri. Tani duhet të lëvizim edhe disa metra.

— Më duket se janë fshatarë.

— Aq më keq. Edhe ata nuk do të na ndahen dhe kushedi sa shumë janë! — tha Petroja.

— Të qëlluj? — pyeti Simoni.

— Kur të të them unë, — iu përgjigj Petroja, pastaj me zë të lartë pyeti:

— Kush jeni dhe çfarë doni?

— Në qoftë se nuk çoheni në këmbë për 10 sekonda, do të qëllojmë, — iu përgjigj një zë burri nga prapa gurit.

— Qëlllo, Simon, dhe të ikim me vrap! — tha Petroja.

Simoni qëllloi me breshëri, ndërsa Petroja u largua me vrap. Pas tij vrapoi edhe Simoni, i cili vazhdonte të qëllonte në ecje e sipër. Nuk vazhduan gjatë. Sikur dolën nga dheu, trupa të fuqishëm iu hodhën sipër dhe për pak minuta ata e panë veten të lidhur dhe të pafuqishëm për asgjë.

— Domethënë nuk më paske harruar? — tha Taqoja, një burrë rreth të gjashtëdhjetave.

— Miqtë e vjetër nuk harrohen, — iu përgjigj

Kristaqi, i cili ishte ulur në anë të oxhakut dhe pinte cigare i qetë. Në sytë e tij dalloje një lodhje. Ata ndrisnin dhe vetëm qepallat sikur i rëndonin. Në dhomë ishin vetëm. Gruaja dhe vajza kishin kaluar në dhomën tjetër.

— Kush është tjetër në shtëpinë tënde? — pyeti pastaj Kristaqi.

Taqoja sikur u përmend nga një ëndërr, lëvizti me të shpejtë dhe tha:

— Jam vetëm. Djali me nusen kanë shkuar në qytet.

— Mirë, — tha Kristaqi. — Do të shkojmë atje.

Në dhomë hyri gruaja dhe pas saj vajza. Në këtë kohë Taqoja dhe Kristaqi ishin çuar në këmbë.

— Duhet të ikim, — i tha Kristaqi gruas. Kjo e vështrroi me ca sy që dukej sikur thoshnin «nuk do të vini prapë?». Kristaqi e kuptoi domethënien e atij vështrimi, po nuk foli. Vajza rrinte në këmbë si e ndrojtur.

— Shpresa... — shqiptoi Kristaqi, — kështu ju quajnë, ë?

— Po — u përgjigj ajo dhe uli kokën, thujse ishte fajtores edhe për emrin.

— Shpresa... — vazhdoi Kristaqi, — a e dini se është një emër i bukur ky? — Vajza qëndronte kokulur. — Epo, natën e mirë, — uroi Kristaqi më në fund dhe i zgjati dorën gruas. Pastaj iu afrua Shpresës dhe i tha: — Kurajo Shpresa, me një dhëndër të bukur, siç je edhe vetë... Dhe për këto që pe sonte asnjë fjalë!..

Kur dolën përjashta, Kristaqi dhe Taqoja ndjenë të ftohtë.



— Qenke shkolluar andej? — i tha Taqoja Kristaqit.

— Jo — u përgjigj tjetri — vetëm me të dëgjuar. Kemi kaq vjet që dëgjojmë për Shqipërinë, për botën që zien.

— Zien, Kristaq vëllai, zien, — ia priti Taqoja me gjysmë zëri.

Po ecnin në një monopat. Rreth e rrotull kishte drurë të lartë. Frynte një erë e freskët.

— E shikon, Taqo, si vijnë kohët? Atëhere nuk deshe të futeshe me partizanët.

Taqoja u drodh kur dëgjoji këto fjalë. Duke ecur me kujdes iu kujtuan ato muajt e fundit të luftës. Ja me këtë Kristaqin ishte atëhere me Ballin. Partizanët përparonin. Radhët e tyre shtoheshin nga dita në ditë. Taqos iu kujtua se atëhere ndjente frikë për fatin e tij. Por ja që nuk i doli keq. Një ditë e thërritën dhe i thanë që të ikte dhe të futej në rreshtat partizane. Ja ky Kristaqi i propozoi. Dhe ai iku. Iku dhe kërkoi falje. U shtir si i penduar, i gënjyer nga propaganda e Ballit. Në rreshtat partizane e caktuan me mushkat e brigadës. Ai kujdesej për to dhe mendohej të ishte korrekt. Vendi u çlirua dhe ai u kthye si partizan...

Kristaqi foli përsëri:

— Taqo, ja tani ti jeton mirë, ndërsa ne jemi jashtë, larg vatanit tonë, larg të dashurve tanë!..

— Epo... — ia bëri Taqoja dhe nuk tha më asnjë fjalë tjetër.

— Ja, o Taqo, miqtë e vjetër nuk harrohen. Dhe ne të kujtuam. Vërtet vonë, por tani na duhesh. Do të na ndihmosh.

Taqoja u drodh kur dëgjoji këto fjalë. Ai qysh kur e pa Kristaqin në shtëpi të asaj gruaje, para-

ndjeu një diçka të keqe dhe në fyt iu mblodh një lëmsh, por e mbajti veten. Ajo e kaluar, për të cilën Taqoja pat kujtuar se qe varrosur njëherë e përgjithmonë, po ringjallej. «Siç duket u ringjallka edhe i vdekuri», mendoi me vete Taqoja. «Ja, ai po del, po heq rrasat e varrit, po më mbërthen për fyti dhe më kërcënon: Ose hajde këtej, ose ta mora frymën» dhe ndjeu se ishte djersirë, megjithëse bënte fresk.

— Pse nuk përgjigjesh? — Zëri i Kristaqit e solli në vete.

— Hë?!

— Të pyes pse nuk përgjigjesh. Çfarë mendon? — pyeti përsëri Kristaqi.

— E për çfarë të të ndihmoj? — Pyetja u shqip-tua me zë kaq të ulët, sa Kristaqi mendoi se mos pësonte ndonjë gjë ky drejt Taqo që i paskej hyrë lepuri në bark dhe, për ta qetësuar, e ndërroi temën e bisedës dhe e pyeti:

— Do të ecim më?

— Edhe pak, — tha Taqoja.

Rreth e rrotull nuk dëgjohej asgjë. Vetëm hapat e tyre krijonin një zhurmë të vogël.

— Pushojmë pak, — tha Kristaqi.

Taqoja, pa iu përgjigjur, u fut poshtë drurëve të lartë dhe u ul. Pas tij shkoi dhe Kristaqi. Taqoja nxori kutinë e duhanit dhe filloi të dridhte një cigare. Duart i dridheshin nga ky takim i papritur. «Si është kjo jetë! — filloi të fliste me vete. — Vitet rrokullisen, por ama nuk u mbuluan dot...» U bë një copë herë që asnjëri nuk po e hapte gojën. Taqoja thithte cigaren i menduar dhe Kristaqi e vështronte me sytë si turjelë.

— Ej, Taqo, Taqo, çfarë ke Taqo, ngrihu! —



ishte zëri i Kristaqit. Taqoja hapi sytë. Përreth  
errësirë... — Ç'pate Taqo, ç'pate, mos vuan nga  
ndonjë sëmundje? — e pyeti i shqetësuar Krista-  
qi kur e pa se ai ishte bërë si i vdekuri në fytyrë.

— Po, — tha Taqoja, — vuaj, dhe nuk jam hiç  
mirë.

— Ndize edhe një cigare nga ky imi. — Kris-  
taqi i dha një cigare dhe ia ndezi me çakmakun e tij.  
Në dritën e çakmakut ai pa djersët e ftohta që  
mbulonin ballin e Taqos dhe duart që i dridheshin.  
«I duhet bërë presion, — tha me vete ai. — I  
duhet kujtuar e kaluara, që të vijë në vete. I duhen  
kujtuar partizanët që ka vrrarë».

— Taqo. Më dëgjo me kujdes... — Kristaqi  
filloi të fliste me zë të lartë. — Në kohën e luftës  
ne të dërguam te partizanët se diç të dinim, sepse  
edhe ti nuk kishe më pak gjynahe se ne, dhe të  
ç'uam andej ja, për këtë ditë. Ç'mendove, se shkuan  
25 vjet dhe të harruam?! Jo, të lamë vetëm që  
t'u fitoje zemrën mirë. Të lamë në heshtje për 25  
vjet që të flasësh tani që është koha e veprimeve  
delikate. Mos harro dokumentin që ke firmosur  
kur u largove nga ne, mos harro partizanët që ke  
vrrarë me dorën tënde, mos harro...

Taqos sikur i ra pika kur Kristaqi i kujtoi  
tërë këto krime me të cilat ai e kishte damkosur  
njëherë e përgjithmonë veten si kriminel e tradhtar  
i atdheut e i popullit të tij.

— Jo, — mundi të thoshte, jo, mos vazhdo.  
Kam menduar se edhe të kaluarën time e fshiu  
lufta.

— Siç na fshiu ne? — pyeti Kristaqi.

— Jo, nuk desha të them atë. Po folë, folë,  
çfarë duhet të bëj?

— Sot — Kristaqi pa orën. Ajo ishte 4 pas mesnate. — Pra sot, në ora 10, festohet 25-vjetori i brigadës së zonës.

— Po, — tha Taqoja.

— Mos më ndërpre, — ndërhyri Kristaqi. Pastaj vazhdoi: — Duhet patjetër që të hedhim fletushka. Këto i kam unë. Mënyra është shumë e thjeshtë.

— Është e pamundur, — tha Taqoja — ka qindra sy që të vështrojnë.

— Mos u ngut, Taqo. Më dëgjo gjer në fund. Këtu kam një pako të mbështjellë. Kjo duhet futur poshtë tribunës. Ka formën e një aparati fotografik. Në orën 10 do të shpërthejë. Kur shpërthen, dëgjohet një zhurmë e vogël, pastaj ngrihet për-pjetë dhe përhapen fletushkat. Është një aparat special. Këtë duhet ta vendosësh para orës dhjetë, me fshehtësi. Frikë mos ki. Aty vijnë shumë fotografë dhe nuk i vete në mendje njeriut.

Taqoja nuk fliste. Ai vetëm dëgjonte me kokën të ulur.

— Ky aksion ka rëndësi, — vazhdonte të fliste Kristaqi. — Ka rëndësi më tepër politike. Do të përhapet paniku, mu në zemër të ish-partizanëve, do të shpërndahen fletushka. Ata janë komunistët më të zgjedhur, garda e vjetër e qeverisë komuniste. Duhet t'u kujtojmë atyre se ne nuk flemë dhe dita e hakmarrjes nuk do të vonojë. Mos harro, kemi kaq vjet jashtë që përgatitemi. Ti e di se kundër komunistëve janë angazhuar forca të mëdha, teknikë, aparatura moderne, radio, stacione televizive. Janë armë të mira këto Taqo, me efekt më të madh se gryka e një pushke. Ti nuk i di mirë tërë këto shpikje të botës perëndimore. . . Po



nejse, ç'ta zgjatim! Do të jetë një mrekulli e vërtetë sot në ora dhjetë...

— Dakord, — tha Taqoja, i cili nuk ishte më ai njeriu në mes të dy rrugëve.

— Kjo është ndofta detyra e fundit. Ne na duhen njerëzit tanë. Ata janë shumë... — Këtu Kristaqi i mëshoi zërit — dhe të gjithë kryejnë detyra. Tani e ke radhën ti. Le të jetë me sukses.

— Të ngrihemi — tha Taqoja. — Shtëpia nuk është më larg se 100 metra.

Kristaqi nuk lëvizi nga vendi.

— Do të nisemi? — pyeti prapë Taqoja, që ishte ngritur në këmbë.

— Shko kontrollo njëherë shtëpinë, pastaj hajde më merr, — tha Kristaqi.

Taqoja u nis, ndërsa Kristaqi mbeti vetëm dhe po mendonte për Petron dhe Simonin: «Vallë ku janë ata të dy? Të kenë kaluar vallë matanë shëndoshë e mirë? Po ato të shtëna që u dëgjuan ç'ishin?»

Duke menduar kështu e kur e pati humbur durimin duke pritur, dëgjoi zhurmë këmbësh. Bëri automatikun gati dhe mbajti vesh. Nga larg shqoi ecjen e Taqos dhe u qetësua. Taqoja erdhi, dhe, duke iu marrë fryma, mezi tha:

— Për pak u morëm në qafë.

— Pse? — pyeti Kristaqi.

— Para se të mbërrija në shtëpi, u takova me një fshatar.

— Ç'donte ai këtej? — pyeti Kristaqi.

— Asgjë — tha Taqoja — Kishte nxjerrë bagëtinë për të kullotur, se do t'i fusë shpejt brenda. Do të shkojë në festë.

— Aha! E çfarë të tha?

— Më tha se dy thyesa kufiri kanë rënë në përpjekje me forcat tona.

— Dhe çfarë? — Kristaqi nuk e përmbajti më dot veten dhe u çua në këmbë.

— Jo, jo, mos ki frikë. Ata kaluan matanë shëndoshë e mirë. Ishte ngritur në këmbë i gjithë fshati.

— Dhe megjithatë nuk i kapën, — tha Kristaqi i kënaqur. — Tani le të shkojmë në shtëpi. «Ata dy gjurmë këmbësh kanë gjetur kur hymë dhe dy veta dolën matanë. Ja, kjo është punë e mençur. Të lumtë, Petro, të lumtë Simon!» vazhdoi me vete Kristaqi.

Në fshat u përhap me shpejtësi lajmi se dy thyesa kufiri kishin hyrë dhe kishin kaluar përsëri matanë. Ai ishte një fshat kufitar dhe të gjithë jetonin me ngjarjet e kufirit. Fjalët që u hapën atë mëngjes tek fshatarët krijuan një gjendje shpirtërore jo të mirë. Atyre u vinte inat që pikërisht aty, në zonën kufitare të tyre, kaluan dy thyesa kufiri. Sepse fshatarët punonin dhe ruanin. Se nga dolën ato fjalë nuk u muar vesh kurrë. Kryetari i degës së punëve të brendshme, i cili kishte ardhur me urgjencë, i tha Aleksit:

— Çdo veprim i yni duhet të jetë i shpejtë. Nuk duhet humbur asnjë minutë. Sapo të gdhijë do të fillojnë të mblidhen nga të gjitha krahinat. Nëpër rrugë do të ketë lëvizje të mëdha. Ish-partizanët do të vijnë grup aty nga ora 9. Në orën 10 fillon



festa. Duhet shpejtësi, Aleks, shpejtësi. Dy të arrestuarit ç'thonë?

— Më shumë heshtin, shoku kryetar. Më duken tipa të çuditshëm. Veçanërisht ai që quhet Simon. Ky është tipi më i lehtë për t'u thyer. Flet më tepër se ai tjetri. Ka qejf të filozofojë. Gjatë përgjigjeve të tij kam nuhatur se ka shenja pakënaqësie ndaj një njeriu, por as emër nuk përmend dhe as vend.

— E keni pyetur për të tretin? — pyeti kryetari.

— Direkt jo, — tha Aleks.

— Duhet pyetur drejtpërsëdrejti. Nuk ka kohë. Po ç'thonë për qëllimin e ardhjes?

— E justifikojnë në mënyrë shumë banale. «Na kishte marrë malli për vendin tonë, — thonë, — dhe erdhëm ta shikojmë».

— Të pyeten përsëri. Të shfrytëzohet ai Simoni, që jep shenja se mund të thyhet më shpejt. Asnjë minutë të mos humbasim.

Aleks e ndjente veten të lodhur. Kishte kaluar mesnata dhe nuk kishte vënë gjumë në sy. E ndjente të mpirë trupin, por truri i punonte me përpikmëri. Qëllimi djallëzor i armiqve e revoltonte dhe ai pothuajse kishte harruar fare se në orën 10 të ditës që po gdhinte duhej të ishte në festë.

— Shkojmë tek ata të dy? — tha kryetari.

— Shkojmë — miratoi Aleks dhe u nis pas tij.

Simoni dhe Petroja po rrinin të strukur në një dhomë në periferi të fshatit. Pasi ishin kapur nga forcat e kufirit dhe populli, ata as që kishin folur

me njëri-tjetrin. Çdo gjë e kishin të qartë. Asnjë fjalë për Kristaqin deri të nesërmen. Atëhere ai do kishte kaluar shumë mirë matanë dhe ata të dy do të ishin të qetë.

Dera e dhomës, ku ishin dy thyesit e kufirit, u hap dhe hynë dy veta. Njërin prej tyre ata e shikonin për herë të parë.

— Kush është Simoni? — pyeti kryetari i degës.

— Unë.

— Nuk të ka me sy të mirë shefi yt. «Leopardi» nuk është i kënaqur nga ti. Të ka hequr edhe vërejtje disa herë. Nuk më thua, pse ke pasur kontradikta me të?

Simoni shtangu. «Ja fundi, mendoi; por, po sikur t'i shfrytëzoj ato fjalë që kam bërë me Kristaqin dhe t'u them se kam qenë kundër tij? ..» Nuk e vendosi dot atë që deshi të bënte, sepse kryetari pyeti përsëri:

— Hë, Simon, pse nuk flet?

Simoni hodhi sytë nga Petroja, i cili kishte ngrirë i tëri. Simoni e kuptoi ç'donte të thoshte ai qëndrim dhe aty për aty u përgjegj:

— Jo vetëm unë, por edhe ky tjetri... — dhe bëri me shenjë nga Petroja; — të dy kemi pasur kontradikta, bile jemi zënë keq me të. Ai nuk është njeri i mirë. Ne kemi qenë kundër tij. Ne vërtet u larguam nga vendi ynë, por nuk kemi menduar kurrë t'i bëjmë keq atij.

— As nuk jeni në gjendje ta bëni këtë, por vazhdoni, vazhdoni, — ndërhyri kryetari.

— Kristaqi është «Leopardi» që ka firmosur këtë letër? — Kryetari nxori nga xhepi një letër që ishte gjetur pak me vonesë në vendin e përpjekjes.



Atë ia kishin dhënë kur ishte nisur për tek shtëpia ku ishin të kapurit.

— Po, ai është, dhe ja ku po ju them, ai na mori në qafë. Nuk është njeri i mirë dhe është shumë dinak.

— Ku ndejtët mbrëmë? — pyetja e kryetarit ishte e prerë.

Simoni përmendi emrin e gruas, pastaj të Taqos

Pas edhe disa pyetjeve të tjera, kryetari dhe Aleksit dolën nga dhoma. Koha nuk priste. Përfundimta kryetari i tha Aleksit se diku kishte lexuar se ujqit, kur janë të uritur, hanë njëri-tjetrin.

Pastaj Aleksit pyeti:

— T'i ndajmë ata tani?

— Patjetër. — tha kryetari.

Aleksit urdhëroi rojet ta bënin këtë gjë dhe i tha kryetarit:

— Nuk dihet se nga, por qarkullojnë zëra se këta të dy kaluan matanë. Mendova ta shfrytëzoj këtë gjë. Të gjithë ata që dinë të vërtetën i porositëm që të heshtin.

— Drejt ke vepruar. Kjo do ta vërë në gjumë Kristaqin. Zaten këta të dy, si duket, vetëm e kanë shoqëruar Kristaqin, me qëllim që të vënë në gjumë vigjilencën tonë. Gjatë kalimit të kufirit e kanë mbajtur Kristaqin në krahë, për të krijuar përshtypjen se kanë hyrë dy. Kur të dilnin, përsëri do të ishin dy, dhe kështu, sipas tyre, ne do të flinim të qetë. Tani sa më parë në shtëpinë e Taqos! Por fillimisht, njëri nga fshatarët më të mirë duhet të kalojë andej dhe të shtiret sikur shpërngul bagëtinë dhe t'ia japë këtë lajm Taqos. Sic duket ky nuk ka zënë mend.

Aleksi u nda nga kryetari për të vepruar sipas porosisë së tij. Ishte akoma natë. Fshati i shumë çezmave atë natë nuk flinte. Të gjithë ishin nëpër prita. Ai ishte një fshat kufitar dhe gjumi nuk mund ta zinte. Këtë gjë Kristaqi nuk e dinte dhe ecte pas Taqos, i qetë, i sigurt me një ndjenjë vetëkënaqësie.

Ngjarjet po zhvilloheshin me shpejtësi.

Fshatari që i dha lajmin Taqos për ata dy thyesa kufiri që «kaluan» matanë u kthye menjëherë tek Aleksi, që ishte aty afër dhe i tha:

— Shoku Aleks, Taqoja po kthehej nga pylli kur vajta unë. E takova, i thashë gjithshka dhe prita i fshehur se si do të vepronte. — Ai u fut në shtëpi, pastaj doli prapë dhe u fut në pyll. Shtëpia është vetëm.

— Ai përsëri do të kthehet, por kësaj here ndofta vetë i dytë — tha Aleksi.

Kryetari i degës dëgjonte me vëmendje dhe aty për aty tha:

— Ne do ta presim brenda në shtëpi.

— Me ne do të vijë edhe ky shoku, — dhe u drejtua nga fshatari, një burrë rreth dyzet vjeç, i vëllai i një dëshmori të luftës.

Të tre u nisën në errësirë. U futën me kujdes në shtëpinë e Taqos dhe pritën.

— Taqon ma lini mua, — tha fshatari. — Atë e rregulloj unë.

— Mirë, — aprovoi kryetari.

Ata prisnin mu tek hyrja kryesore.

Të gjithë i kishin armët gati. Kristaqi duhej kapur i gjallë. Me kujdes, çdo veprim duhej kryer me kujdes.

Asnjë lëvizje e tepërt. Kristaqi, «Leopardi»,



duhej të binte në çark. Nga larg u dëgjuan ca lëvizje të lehta.

— Zini vendet! — tha kryetari. Hapat afro-heshin gjithnjë. Hapat u afruan shumë. Asnjë zë. Përjashta kishte filluar të agonte. Hapat qëndruan në vend. U shty dera. U fut i pari Taqoja. Pas tij një tjetër. Asnjë lëvizje. Qetësi. Taqoja lëvizi. Pas tij edhe Kristaqi. Fshatari iu hodh Taqos. Aleks i Kristaqit. Taqoja ra shpejt dhe bërtiti. Kristaqi rezistonte. Edhe një lëvizje tjetër dhe Kristaqi ra. Të dy ishin shtrirë. Kryetari ndezi elektrikun e dorës.

— I poshtër, — tha Kristaqi. Taqoja e kuptoi që ato fjalë i drejtoheshin atij dhe mbylli sytë. Aleks i doli jashtë dhe fishkëlleu tri herë. Në çast nga pylli rreth e rrotull dolën njerëz të armatosur.

— Duhet të nisemi, — u tha Aleks. — Prega-tituni!

Aleks i fut brenda. Kryetari po shikonte çantën e Kristaqit, të cilin e kishin lidhur ashtu si dhe Taqon.

— Po këtë aparat fotografik, ç'e ke dashur? — e pyeti kryetari Kristaqin. Ky vështroi në sy Taqon dhe u përgjigj:

— Më ka ngelur në çantë rastësisht.

— Atëhere të bëjmë një fotografi — tha kryetari dhe ngriti aparatin.

— Mos, — tha Kristaqi — nuk ka ndriçim të mjaftueshëm.

— Nuk prish punë, — tha kryetari.

— Jo, të lutem, jo. — Kristaqi ishte zverdhur.

— T'u dhimbska jeta — tha kryetari dhe vuri me kujdes aparatin mbi tavolinë.

— Minë! thirri Kristaqi, — minë me forcë shpërthyesë të madhe!

Taqoja, kur dëgjoi këto fjalë, u kthye nga Kristaqi dhe i tha:

— Me paske gënjyer?

Aleksi, pa e lënë të mbarojë fjalët, ia priti:

— Nuk është hera e parë që gënjehesh, Taqo! Taqoja heshti. Kristaqi ndjeu shijen e gjakut në gojë. Nga shtrëngimi i nofëllave dhe i dhëmbëve i kishte dalë gjak. Ishte një inat që i vlonte përbrenda dhe nuk dinte kujt t'ia nxirrte. «Por hëpërhë, mendoj, duhet t'u përgjigjem për sa më pyesin».

U çua në këmbë dhe qëndroi drejt.

— Simonin dhe Petron do t'i takosh së shpejti. Uluni dhe mos u mërzitni.

Kristaqi uli kokën, pastaj u përkul lehtë dhe shau nëpër dhëmbë. Aleksit i zuri veshi se ai shqiptoi emrin Simon, të cunguar, pa disa gërma, dhe iu duk një emër i gërryer e i sakatuar.

\* \* \*

Në ora 10 çdo veprim kishte marrë fund. Në fshatin me shumë kroje e me shumë ujë, tre thyesa kufiri dhe dy armiq ishin kapur dhe do të shoqëroheshin për në qytet. Rruga automobilistike kalonte afër vendit të festës.

Aleksi rrinte në makinë dhe vështronte atë shesh të vogël, të zbukuruar me flamuj, të mbushur plot me njerëz, që këndonin e hidhnin valle. Lart, në kupë të qiellit ndriste një diell i ngrohtë. Deri në makinë vinin tingujt e këngëve të gëzuarra. Në vesh Aleksit i kishte mbetur refreni i asaj




kënge të bukur, me ato vargje tronditëse, që shpreh-  
nin një të vërtetë të madhe:

. . . . .  
Çdo lëvojë si top dyfeku!  
Çdo kërrejë flakë stralli!

Makina kaloi fare pranë vendit të festës. Ish-  
-partizanët parakalonin me grushtin lart para tribu-  
nës. Brenda në makinë ishin ata, armiqtë. Aleksi  
i vështroi me neveri. Pastaj ktheu sytë nga ish-par-  
tizanët dhe tha me vete:

— Po, shokë, edhe unë jam në festë, jam aty  
në radhët tuaja, mes jush... Lufta ende s'ka mba-  
ruar...



## TEK VARRI I GRUAS SË JOZEFIT

Avioni çau me uturimë drejt pistës. Shpejtësia sa vinte e ulej. Ishte pranverë, por një shi i imtë kishte njomur pistën e aeroportit. Të krijohej përshtypja se tërë ajo masë e hekurt nuk do të qëndronte dot. Këtë përshtypje ta forconte edhe fakti që avioni i markës së fundit ishte tepër i madh, dhe për herë të parë prekte pistën e aeroportit tonë. Më në fund avioni qëndroi. Punonjësit e aeroportit afruan shkallët dhe nga avioni filluan të



zbrisnin turistët. Turmat laramane binin menjëherë në sy në tërë sfondin gri. Përfaqësuesit e albturizmit iu afruan grupeve të turistëve dhe u përshëndetën me ta. Midis tyre ishte edhe përkthyesi, një djalë rreth 27 vjeç, i quajtur Jorgo.

— Kush është përkthyesi? — pyeti njëri prej turistëve duke hedhur një vështrim të papërcaktuar në grupin e shqiptarëve që kishin dalë për t'i pritur.

Jorgoja i dha dorën turistit që pyeti. Fytyra e tij Jorgos i ngjalli një ndjenjë jo të mirë. «Mos është nga ata tipat kuriozë, që të bezdisin me pyetje me vend e pa vend?», mendoi Jorgoja dhe i hodhi edhe një herë vështrimin fytyrës së turistit. Ajo iu duk si pikëpyetje. Ky krahasim ndofta i erdhi nga që turistin e mendoi qysh në fillim si tip kuriozi jashtë mase, që do ta mundonte me morinë e pafund të pyetjeve.

— Unë kam dëshirë të njihem me vendin tuaj. Shqipërinë e kam dashur gjithmonë. Kur të flasin për të, të duket sikur dëgjon një përrallë të bukur, që ke qejf të ta përsëritin vazhdimisht për të papriturat e saj që shtohen vazhdimisht, — tha turisti duke iu drejtuar Jorgos. — Shqipërinë e kam krahasuar vazhdimisht me heroin e legjendave që ndonëse nuk i bie më qafë kurrkujt kurdoherë bëhet objekt i sulmeve. Dhe Shqipëria porsi ai heroi i legjendave kurdoherë ka fituar, sepse çështja e saj ka qenë kurdoherë e drejtë. Historia juaj e provon më së miri karakterin mbrojtës të luftërave që keni bërë, — vazhdoi pastaj turisti. Jorgoja dëgjonte. I huaji dinte shumë gjëra për Shqipërinë. Admiringimi i tij ndaj vendit tonë dukej sheshit dhe Jorgoja mendoi se do të bënte mirë t'i fliste shumë

gjëra këtij të huaji, i cili nuk e shikonte Shqipërinë vetëm si një vend me bukuri natyrore dhe objekte antike arkeologjike, por dhe si një vend me një histori luftarake.

— Shqipërinë e kam dashur edhe për një arsye tjetër. Në tokën tuaj është varrosur motra ime, — tha turisti.

— Motra juaj? — Jorgoja nuk e fshehu habinë që i shkaktuan këto fjalë.

— Po, po, motra ime... — tha turisti dhe konstatoi me kënaqsi habinë e përkthyesit.

Jorgoja nuk e kishte të qartë, se si kishte ardhur e motra e këtij të huaji, kur, dhe ku kishte vdekur. Moria e pyetjeve sa vinin e shtoheshin në kokën e tij, por i huaji nuk pushonte së foluri. Tani po udhëtonin për në Tiranë dhe i huaji ishte ulur afër tij.

— Motra ime, — thoshte i huaji që shokët e thërrisnin me emrin Hans, — ishte e martuar me një oficer. Kjo ka ndodhur që në Luftën e Parë Botërore. Unë atëhere sapo kisha lindur. Isha fëmija më i vogël i familjes. Motra ishte e madhja. I shoqi u vra, ndërsa ajo mbeti këtu. Unë time motër s'e kam parë kurrë dhe kjo për disa është një arsye që mos të të dhimbset. E kanë gabim, shumë gabim. Njeriun edhe pa e njohur mund ta duash. Veç kësaj ajo ka qenë një grua e mençur, e ditur. Më dërgonte vazhdimisht letra. Dhe fliste mirë për Shqipërinë, për zakonet tuaja. Kam disa fotografi të saj. Deri në një farë mase i njoh ambientet shqiptare. Tani që eci në tokën tuaj më duket sikur takoj motrën time...

— Të çfarë viti i ke fotografitë? — pyeti përkthyesi.



— Të vitit 1926, por edhe të mëvonshme. Kam edhe të vitit 1946. Shqipëria më ka pëlqyer gjithmonë.

— Vendi ka ndryshuar shumë. Nuk ka më gjurmë të atyre viteve, — u përgjigj Jorgoja pa e kthyer kokën nga i huaji. Në çast kapi çelësin e mikrofinit dhe filloi të fliste në gjuhë të huaj:

— Kjo është një fabrikë e ndërtuar para dy vjetësh. Ndërtimi i saj u preu rrugën shumë materialeve që më parë importoheshin. Ajo është fryt i përpjekjeve të punëtorëve dhe inxhinierëve shqiptarë...

Të huajt vështronin nga krahu i majtë fabrikën e re dhe dëgjonin me vëmendje zërin e përkthyesit, që vinte i qartë dhe i plotë nga altoparlantet...

\* \* \*

Astriti hapi një dosje ngjyrë kafe. Përballë rrinte shoku i tij pak më i madh në moshë. Dosja ishte e madhe, dhe pluhuri që kishte rënë sipër saj, përveç një shkujdesjeje të punonjësit që merrej me to, tregonte se ajo kishte vite që s'ishte hapur.

— Jo çdo gjë e mbulon pluhuri i harresës, — tha Astriti duke i zgjatur shokut një fletë të shkruar nga të dy anët. Tjetri e mori në dorë dhe filloi të lexojë:

*«Dëshmi e të pandehurit Halim S.....»*

*Ne dinim diçka, se pikërisht në atë shtëpi  
vinin partizanë të plagosur dhe mjekoheshin. Por  
ky ishte vetëm dyshim dhe patjetër duhej ta*

verifikonim. Shtëpia ishte në fund të një lagjeje me shtëpi përdhese. Nga ndërtesa e komandaturës gjermane dukej pothuaj e gjithë lagjja. Unë me kapitenin Otto dilnim shpesh në ballkonin e zyrës së tij dhe kundronim lagjen. Ottoja ishte i apasionuar pas letërsisë dhe shpesh i krahasonte shtëpitë përdhese në ngjyrë të kuqe me foletë e fshehta të milingonave. «Ne duhet të gjejmë vrimat se ku fshihen ilegalët, — më tha ai një ditë. — Dhe a e dini, zoti Halim, se si mund t'i gjejmë?» «Jo», iu përgjigja.

«Më dëgjo mua, atëhere», më tha. Unë ngrita veshët dhe u ktheva nga ai. Ottoja kishte ca huqe dhe i ngelej qejfi shumë po të mos veproje ashtu siç dëshironte. Unë u ktheva shpinën shtëpive përdhese dhe humba i tëri në sytë e Ottos, që lëvrinin plot gjallëri. Ishte një ditë jashtëzakonisht e bukur dhe e ngrohtë, dhe shkëlqimin e syve të Ottos e dalloje menjëherë. — Milingonat, — kështu e nisi shpjegimin ai, — i ndërtojnë foletë e tyre në damarët e tokës. Diku, pasi bëjnë disa rrugë gjarpëroshe, ato depozitojnë ushqimin. Këto janë vende të përshtatshme dhe të sigurta. Ti mund ta ndjekësh milingonën nga pas, t'i afroresh afër vrimës ku futet ajo, mund të gërmosh lehtë e lehtë, por megjithatë me vështirësi e gjen vendin e ushqimit. Kështu është edhe me këtë lagje. Ne e dimë se këtu strehohen ilegalë. Ditën ata ushqehen, flenë, shtypin trakte, e kushedi ç'dreqin bëjnë. Ja, shiko rrugët. — Unë hodha sytë nëpër rrugicat e lagjes. Ato ishin të shumta dhe plot dredha. Nëpër to ecnin shumë njerëz. Portat e shtëpive përdhese herë hapeshin e herë mbylleshin. Njerëzit ecnin nëpër rrugët gjarpëroshe. Kishte midis tyre pleq, që mezi



hidhnin këmbët, gra me kryet të mbuluar me napë të zeze, punëtorë, fëmijë. Lagjja ishte tërë lëvizje dhe, të them të drejtën, më pëlqeu krahasimi që i bëri Ottoja me lëvizjet dhe foletë e milingonave. Por edhe në qoftë se nuk do të më kish pëlqyer, unë do të buzëqeshja dhe do të pohoja me kokë. Ottoja zemërohej kur ndokush i bënte kundërshtimin më të vogël. Unë ia njihja karakterin dhe vazhdimisht i buzëqeshja. Këtë ai e pëlqente. Arsyen nuk e di. Ndofta ngaqë buzëqeshja atij i mungonte vazhdimisht. Unë në fillim nuk e kuptoja dot sjelljen e Ottos: ai ishte i dhënë pas letërsisë dhe në mendjen time këta njerëz duhej të ishin vazhdimisht të qeshur. Ndryshe, arsyetoja unë, nuk mund të hidheshin në letër tërë pasionet njerëzore. Por, më vonë, duke parë punën e tij, e kuptova se ajo ia hiqte buzëqeshjen e domosdoshme.

«— Ja, pra, nëpër këto rrugë ecin ata, — fliste Ottoja. Ata i njohin mirë, i dinë të fshehtat e tyre. Por është vështirë të njihesh me tërë ato rrugica. Shumica e tyre janë pa emra. Është e pamundur të emërtosh mijëra rrugë. Veç kësaj, shqipëtarët, me sa kam dëgjuar, janë shumë të kursyer në emra. Është disi e çuditshme dhe të shkakton habi ndërtimi i këtyre lagjeve, me shtëpitë kaq afër njëra-tjetrës. Fusha ka plot rreth e rrotull, megjithatë shtëpitë ngjiten njëra me tjetrën. Ndofta, edhe ndërtimet shprehin në një farë mase shpirtin e një populli. Diku e kam lexuar këtë dhe i dhashë të drejtë autorit. Përbërja shpirtërore nuk ka si të mos shprehet në elemente të veçanta të objekteve të banimit. Ja, shtëpitë e tyre janë afër, shumë afër njëra-tjetrës. Kjo ka të bëjë, ndofta, me unitetin tuaj. Gjithmonë të vegjël. Dhe i vogli

ka nevojë për përkrahje, për ndihmë. Qytetet janë më pak të mbrojtura dhe ndihma e parë që mund të të jepet është ajo e komshiut. — Unë e dëgjoja Otton, dhe megjithëse kisha mbaruar studimet në Austri nuk kisha lexuar asgjë për urbanistikën, arkitekturën. Le që për qytetin tonë as që mund të bëhej fjalë për urbanistikë. Asnjë arkitekt nuk kishte vënë dorë mbi të. Doja t'i thoshja Ottos diçka të kundërt, por nuk dija si ta formuloja mendimin që të mos binte erë kundërshtim. Megjithatë, pa dashje, më shpëtoi fjala «fshatrat». Ai, siç duket, më kuptoi dhe duke folur tërë pasion tha: — Shiko, këtu është diçka tjetër, krejt ndryshe nga qyteti. Në fshatra, vërtet shtëpitë janë ndërtuar ndryshe nga këtu, por edhe kjo është një formë që në thelb shpreh të njëjtin ndërtim si në qytet. Unitetin, mbrojtjen ata e kompensojnë me diçka tjetër. Elementet e domosdoshme që kompensojnë afërsinë me njëri-tjetrin janë kullat e larta, mali dhe mungesa e rrugëve të komunikacionit. Kjo e fundit është në favor të tij, pasi vështirëson afrimin e rrezikut. — Ottoja fliste tërë gjallëri dhe për asnjë çast nuk i hiqte sytë nga shtëpitë përdhese. Ottoja ishte njeri me kulturë dhe fliste rrjedhshëm. Por diskutimi i tij më dukej i kotë, duke pasur parasysh se flitej për ato shtëpi përdhese ku, në përgjithësi, jetonin njerëz injorantë. Por Ottoja duhej të dilte diku, dhe tërë ato fjalë ai nuk i tha pa qëllim. Unë këtë e dija mirë. Ottoja nuk fliste kurrë drejtpërdrejt. Ai në fillim të fliste për gjëra anësore dhe gradualisht të fuste në vorbullën e asaj që e shqetësonte. Thashë që në fillim se ai e kishte qejf letërsinë dhe mbi çdo gjë tërheqëse do të meditonte. Shtëpitë përdhese



për të nuk kishin interes as etnografik e as arkitektural. Këtë gjë e dija mirë, e megjithatë më tërhiqte shpjegimi i tij për urbanistikën, lidhjen shpirtërore midis psikikës së një kombi, ose të njerëzve të veçantë, me ndërtimet. Ottoja më në fund, pa i hequr sytë nga lagjja, më tha: — Ky është një diskutim i gjatë dhe, me gjithë dëshirën tonë të mirë, nuk mund ta zgjidhim këtu mbi ballkon. Me Marijen a njihesh? — Pyetja e Ottos më erdhi kaq e papritur dhe e befasishme sa në një rast tjetër dhe në kushte të tjera do t'i thoshja «ohu, nga urbanistika tek Marija, një zbritje e menjëhershme, që të provokon të qeshura!», por në këtë rast duhej t'i përgjigjesha menjëherë, dhe ashtu bëra. Ottoja pastaj u kthye nga unë dhe më tha: — Ajo është një grua e mrekullueshme. Është ndër të rrallat që i është përshtatur mënyrës së jetesës shqiptare. Nuk di, si ia ka arritur, por, të them të drejtën, unë do ta kisha mjaft të vështirë. Çdo popull ka natyrën e tij të pandryshueshme. Historia i ka caktuar secilit rolin e vet në zhvillimin botëror. Raca ariane, bie fjala, nuk mund të bastardohet dhe të humbasë individualitetin, të shartohet me raca të tjera. Kjo gjë ruhet me fanatizëm nga ne vetë dhe, çdo përpjekje e kundërt, do të përfundonte pa sukses. Papërkulshmëria e racës sonë shprehet në sukseset e ushtrisë, në pathyeshmërinë e saj. Kjo shpjegohet me rolin e kësaj race për të udhëhequr dhe për t'i paraprirë botës. Por, megjithatë, unë e kuptoj Marijen, arsyet që e kanë shtyrë atë të bëhet një banore me të tëra karakteristikat dhe cilësitë e njerëzve të këtyre shtëpive përdhese. Ajo është bërë milingonë e këtyre rrugicave dhe pa vësh-

tirësi mund të na çojë atje ku duam. Marija është e gatshme. Takimi ynë me të nuk do të ishte fort i përshtatshëm. Ajo është grua e huaj dhe shqip-tarët, pavarësisht se e afrojnë, nuk e besojnë shumë. Është më mirë që lidhjet me të t'i mbash ti. — Ottoja më në fund u fut në luadhin ku donte të kornte bar. Unë këtë e prisja me kohë dhe, kur më doli direkt në terren, të them të drejtën, u drodha. Jo se kisha frikë, edhe dëshira nuk më mungonte, por në atë kohë ishin shpeshuar aksio-net e guerileve të qytetit. Kaq papritur vepronin ata, sa vetëm kur shikoje para fytyrës tytën e revolverit dhe dëgjoje ca fjalë të ashpra e të rënda si plumb, kuptoje se ekzistenca jote merrte fund. Kjo ishte arsyeja që u drodha kur Ottoja më propozoi direkt për të punuar me një njeri të dytë, për një mision të veçantë: zbulimin e një baze ilegalësh. Unë deri në atë kohë kisha informuar gjermanët vetëm për gjëra që i kisha konstatuar vetë.

Ottoja tani e kishte hequr vështrimin nga shtë-pitë përdhese dhe më shikonte në fytyrë me një vështrim hetonjës. — Hë, si thua? —, më tha më në fund ai. Kjo nuk ishte pyetje, ishte urdhër dhe mua s'më ngeli gjë tjetër, veçse të takohesha me-njëherë me Marijen. Duke u ndarë nga Ottoja, ai nuk harroi të më kujtonte një element që do të më hynte shumë në punë: — Marija e zotëron mirë artin e të qëndisurit. Kjo i hap dyert e çdo shtëpie, — më tha ai dhe më uroi sukses në detyrën e re. Kur dola nga zyrat e komandaturës kaq isha hu-tuar, sa me vështirësi orientohesha nëpër rrugë. Biseda me Otton, në dukje aq e përgjithshme, shkaktoi tek unë një efekt jashtëzakonisht të



*madh, aq sa m'u desh kohë që të vendosja marrëdhënie normale me ambientin...»*

Më poshtë vazhdonin deponimet e të pandehurit Halim S... se si u takua me Marijen, si e futi atë në shërbim, gëzimin me të cilin e priti ajo propozimin.

Astriti, duke rrotulluar lapsin nëpër duar, ngriti kokën dhe i tha Gencit.

— Lexoje më poshtë.

Genci uli sytë mbi fletët e daktilografuara dhe tha:

— Astrit, është e çuditshme, po deponimet e tradhëtarit Halim S... janë shumë të qarta.

— Ashtu është, — u përgjigj Astriti, — Shokëve tanë u është dashur një punë e madhe për ta zbërthyer. Ai ishte mjaft dinak dhe gjatë procesit hetimor për çdo pyetje kishte nga një alibi. Ka qenë njeri me kulturë. Gjermanët e kishin rekrutuar qysh kur ishte student në Austri. Kam biseduar me një shokun tonë të vjetër, ish pjesëmarrës në njësitet guerile të qytetit. Celula e Partisë kishte marrë vendim që ai të pushkatohej, por ai mundi t'i shpëtojë ndëshkimit gjatë viteve të luftës. Pas Çlirimit, ai u fsheh me një emër tjetër dhe mundi të jetojë edhe dy vjet të tjera i lirë. Më në fund organet e SEMP-it<sup>1)</sup> e arrestuan. Po, lexoje dëshminë e tij, lexoje.

Genci gjeti vendin ku kishte ndërprerë leximin dhe vazhdoi:

---

1) Seksionet e mbrojtjes së popullit — organe që kryenin funksionet e organeve të Sigurimit të Shtetit.

«Një ditë prej ditësh, nuk më kujtohet se ç'datë ishte, kapiteni Otto më thirri në komandaturë. Më priti në zyrë. Si zakonisht, u çua në këmbë, më zgjati dorën dhe më ftoi të ulesha. Atë ditë më bëri një pyetje jo të zakonshme. — Nuk keni frikë, kur vini në mes të ditës në komandaturë?

Në fillim nuk iu përgjigja, por pastaj e mblodha veten dhe i thashë: — Nuk kam arsye pse të frikësohem. Qyteti e di se unë zotëroj gjermanishten dhe vij tek ju vetëm si përkthyes.

Kapitenit Otto i pëlqeu përgjigjja ime dhe më zgjati paketën e cigareve. Unë mora një cigare dhe e ndeza. — Cigarja të qetëson nervat — më tha ai. — Më tepër krijohet iluzioni i qetësisë — iu përgjigja. Për këtë gjë fola tërë siguri, pasi ai ishte futur në terrenin tim. Unë isha mjek dhe dija shumë më tepër nga ai. — Sidoqoftë, të qetëson — tha ai përsëri, dhe në çast më pyeti: — Një nga bazat ilegale u zbulua. Mundëm të kapim vetëm një partizan, i cili kishte zbritur nga mali për t'u mjekuar. Në hetuesi do të jeni ju si përkthyes. Do ta marr vetë në pyetje.

Unë nuk dija se për cilin partizan flitej, prandaj e pyeta Otton: — Partizani nga qyteti ynë është? — Po, — m'u përgjigj, — ka mundësi t'ju njohë edhe ju. Prania jote në hetuesi mund t'i ngjallë dëshirën ekstreme për të mohuar gjithshka. Veç kësaj, ai do të mendojë se po të flasë, ju do të jeni dëshmitari i vetëm që do të dijë të vërtetën. Kjo do të jetë në disfavorin tonë. Prandaj gjatë procesit hetimor ju do të flisni me të si me një bashkatdhetar, të krijoni intimitet, në ndonjë rast ju lejoj të na shani, për t'i dhënë atij të kuptojë se edhe ti nuk e pëlqen Gjermaninë. Rrethanat janë të tilla, që njeriu



duhet të veprojë kundër dëshirës së tij. I dashur Halim, njeriut në jetë i duhet të luajë shumë role! Në një farë mase jeta e njeriut është si ajo e aktorit, ku në çdo pjesë ka një rol të ndryshëm nga i pari. Kjo është logjika e jetës dhe njeriu është i pafuqishëm për ta kundërshtuar atë. Dakord? — Pyetja e Ottos ishte nënshkrimi im i pranimit dhe unë s'bëra gjë tjetër veçse ula kokën në shenjë pohimi. — Atëhere të shkojmë qysh tani në qeli, — tha Ottoja. Unë i shkova pas. Borsalinën e lashë në zyrën e tij. Rrugës për atje, kapiteni më tha se partizani gjatë rrethimit të shtëpisë kishte qëlluar me armë dhe ishte plagosur përsëri nga zjarri i armëve gjermane. Gjendja e tij shëndetësore ishte jo fort e keqe, pasi ia kishin mjekuar plagët. Qelitë ishin në bodrumin e ndërtesës së komandaturës gjermane. Aty vinte erë myk. Lagështia ishte tepër e madhe, megjithëse ishte muaji korrik. Në cepin e qelisë, afër dritares, e cila ishte mjaft lart, rrinte ai, partizani i plagosur. Kur u hap dera, ai ktheu sytë nga ne. — Doktor, shiheni edhe ju. Më duket se gjendja e tij po përmirësohet, — tha Ottoja. Partizani nuk foli. Unë shkova drejt tij dhe i hodha dorën në sup. Ai ma largoi me forcë dhe më hodhi një vështrim të egër. Unë u tërhoqa menjëherë, por aty për aty e mblodha veten dhe e pyeta: — Mos ju dhembti plaga? — Partizani nuk m'u përgjigj. — Afrohu, doktor, ata tremben nga mjekët. Jeta u kalon pa asnjë vizitë mjekësore dhe, doemos, kontaktet e para me mjekët, i frikësojnë... — Unë, me urdhër të Ottos, përktheva. Partizani i plagosur u çua në këmbë, drejtoi me vështirësi trupin, dhe tha: — Po, me mjekët fashistë ne nuk takohemi kurrë. — Unë përktheva. Kjo për mua ishte si ai pickimi i grenzës, që të vjen papritur. Hodha sytë nga Ottoja.

Ai buzëqeshi. Kjo, që i mungonte atij vazhdimisht, kësaj here doli kaq shpejt dhe papritur, thua se një dorë e padukshme e vuri në cep të buzëve të tij. — Kjo është një akuzë krejt e padrejtë. Ju, doktor, mos u zemëroni. Këtij djaloshi kështu i kanë thënë dhe ai kështu do të thotë. Djaloshi nuk e di se shkencat nuk ka të bëjë fare me politikën. Mjekut i intereson sëmundja e njeriut dhe jo bindja politike e tij. Humanizmi i mjekut qëndron mbi bindjet politike, djalosh. Literatura këtë thotë, praktika botërore e mjekësisë këtë konfirmon. — Unë përktheva fjalët e Ottos. Djaloshi, pasi i përktheva fjalët, m'u drejtua: — Unë kam njohur mjekë, në mal, që nuk konfirmojnë as atë që thoni ju, e as praktikën tuaj botërore. Në qoftë se do të ishte e vërtetë ajo që thoni ju, ata mjekë nuk mbathnin opinga e nuk hidhnin torbën krahut me një misërnike me qepë, por rrinin klinikave, kështu si bashkëpunëtori juaj, mjek. Dhe tani përktheni fjalë për fjalë. — Unë përktheva me mundim. Qenë ato minuta një lodhje e madhe, jo se nuk gjeja dot fjalët e përshtatshme, jo. — Ti, Halim, e zotëron mirë gjermanishten, aq mirë sa çdo i huaj do të ta kishte zili, — më pat thanë dikur një pedagog në universitet. — Të kishe vazhduar për lingvistikë, do të ishte një gjë e mrekullueshme. Si në çdo fushë edhe për gjuhë të huaja ekzistojnë prirjet, — pat shtuar ai pastaj. Fjalët e djaloshit partizan unë i përktheva me vështirësi, për arsye të tjerë. Duke parë fytyrën e Ottos, fjalët e humbisnin kuptimin e tyre të zakonshëm, lidhjet gramatikore më megjulloheshin, parashtesat, foljet, prapashtesat, mbiemrat dhe ndajfoljet më plekseshin me njëra tjetrën dhe nuk ua gjeja dot vendin. Ato u ngjanin atyre reparteve të shpartalluara që edhe komandanti



më i zoti nuk është në gjendje t'i vëjë në pozicionet e para të luftimit: Ushtari delte para mitralozit të tij, tjetri shtinte dhe ushtari rrokullisej, folja dilte para emrit, para saj mbiemrat dhe u bë një mpleksje deri sa Ottoja, me zë të ulët tha: — Zoti Halim, unë të kuptoj drejt. Mos harro se dua një përkthim fjalë për fjalë. Mos u mundo të rregullosh frazën. — Djaloshi partizan nuk kishte lëvizur fare nga pozicioni që foli, dhe priste se ç'efekt do të bënin fjalët e tij. Kështu m'u duk mua, të paktën. — I thuaj partizanit pse erdhi në qytet dhe kush e solli? — pyeti Ottoja. Djaloshi u përgjigj dhe unë përktheva këto fjalë: — Këtë pyetje duhet t'ua bëjmë ne, dhe jo ju. Dhe pyetja jonë po bëhet mirë me grykën e dyfikut. Sa për atë, se kush më solli, po përgjigjem shkurt: Unë e njoh vendin tim me pëllëmbë, aty kanë ecur, janë rritur dhe futur në jetë, nëna, babai, vëllai... Ata më kanë marrë për dore dhe unë di çdo rrugicë, çdo qoshe. Mua më sollën këmbët e mia. Për në shtëpinë tënde nuk duhen shoqërues. Ju, që nuk e njihni vendin, ju duhet edhe Halimi edhe Marija. — Emri Marije më coroditi. Nuk dija ç'të bëja. Ottoja humbi qetësinë, një muskul i faqes së djathtë filloi t'i lëvizte me shpejtësi dhe ai mundi të thotë vetëm fjalët «përktheni». Unë përktheva. Më kishte pushtuar frika. Përmendja e emrit «Marije» më ngarkonte me përgjegjësi edhe mua. Atë, atë, Marijen, që s'duhej ta mësonte kush se ç'mision kishte, përveç Ottos dhe meje, e përmendte edhe djaloshi partizan. Kjo do të thoshte se për ne ajo ishte e pavlefshme. Por jo, s'duhej të nxitoheshim. Duhej pyetur partizani, duhej pyetur me durim, mos ai ishte konstatim vetëm i tij. Ah, të ishte kështu! Dëshmitarin e vetëm e kishim në dorë dhe e qëronim. Por po të kishte të tjerë? Këtu

ndryshonte puna. Por duhej pyetur partizani, ky ishte mendimi im. Edhe Ottoja, siç më tha vetë, këto mendonte. Por partizani donte të fliste akoma. Unë në fillim nuk e lejova, por Ottoja ma bëri me shenjë që ta lija. Partizani tha: «Maria juaj, zotërinj, është spiune e fëlliqur. Ne s'kemi nevojë për qëndizmat e saj. Është kohë lufte dhe paja e vajzave tona është dyfeku, krushqit janë shokët e saj dhe dasma për-pjekja me ju, betejat. — Unë ia përktheva Ottos dhe ai, duke më shikuar me inat, më tha që ta ndiqja nga pas. Dolëm nga qelia dhe ngjitëm shkallët. Në zyrë ai më tha: — Në qoftë se ke bërë gabimin më të vogël në lidhje me udhëzimet që i ke dhënë Marijes, do të futesh në qeli bashkë me partizanin. Qysh sot nuk do të takohesh më me Marijen. I qartë? — Unë vetëm i thashë se kisha vepruar me kujdes dhe kisha zbatuar çdo udhëzim të tij, por ai nuk donte të më dëgjonte.

Pas një çerek ore ishim prapë në qeli. Me ne ishte edhe një nënoficer gjerman. Partizanin po e torturonin. Unë përktheja. Partizani akuzonte gjermanët. Ottoja bërtiste. Nënoficeri qëllonte. Unë isha mësuar me gjakun, pasi isha mjek. Por atë ditë u trondita. Sytë më kanë parë një skenë të llahtarshme. Partizani qëndronte me kokën lart. Gjaku i kullonte nga tëmthat. Unë heshtja dhe vetëm kur Ottoja pyeste, unë flisja. Partizani m'i ngulte sytë në mënyrë shumë të çuditshme. Unë isha i një kombi me të, por vështrimi i tij nuk më ngjante se i drejtohej një bashkatdhetari. Kjo gjë më nxiti që t'i bëj një pyetje partizanit. Në një çast heshtjeje e pyeta: — Ne jemi bashkatdhetarë. Pse me mua sillen ndryshe këta, e ty të godasin? — Për herë të parë gjatë gjithë kohës që kisha qenë me të, partizani buzëqeshi pak dhe tha: — Mua do



të më vinte turp nga vetja po të asistojë në një skenë të tillë çnjerëzore. Të huajt të të goditnin ty, dhe unë të rrija të vështroja? Kjo do të ishte vdekje për mua. Ti nuk je më shqiptar. Ti i rëndohesh tokës souë. Çiban i keq . . . — Kapiteni Otto kërkoi t'ia përktheja, por unë nuk ia thashë të plotë. Megjithatë Ottoja më ofendoi keq kur më tha: — Hajvan! Çfarë kujton? Ku je? Në sallë leksionesh, që drejton pyetje të tilla? Dil përjashta e më prit në korridor. — Unë dola dhe, kur shtyva derën e qelisë, pashë për herë të fundit fytyrën e njomë të partizanit, që më vështronte me urrejtje. Kjo ishte hera e fundit që pashë atë fytyrë, pasi dy ditë më vonë, partizanin e pushkatuan pa i nxjerrë gjë nga goja.

Siç mora vesh më vonë, Marija punoi për gjermanët dhe i ndihmoi mjaft. Ottoja e la vetë këtu. Ajo do të takohej me një njeri tjetër. Ottoja, me sa më tha Marija më vonë, ishte urdhëruar që asaj t'i linte porosi të reja. Ndofta kjo ka lidhje me arkivat gjermane që ranë në duar të amerikanëve. Por fakti që ajo pas luftës u lidh me amerikanët flet për vërtetësinë e atyre që thashë më lart . . .».

Genci ndërpreu leximin dhe u mbush me frymë. Astriti u çua nga karrikja dhe iu afrua dritares. Jash-të ndriste një diell i ngrohtë. Një erë e lehtë përkundte gjethet e pemëve. Në rrugë kalonin shumë njerëz. Ora ishte dy dhe punonjësit ndërronin turnet, administrata mbyllte zyrat. Kalimtarët ecnin shpejt. Genci mbylli dritaren, futi dosjen ngjyrë kafe në kasa-fortë, dhe tha:

— Astrit, dalim. Ora shkoi. Mbasdreke do të vijmë prapë.

— Genci, — tha Astriti — a e ke parë atë par-

tizinin për të cilin shkruan në dëshminë e tij tradhtari Halim S.

— Jo, — u përgjigj Genci. — Ose e kam parë dhe s'më kujtohet.

— Çdo ditë e shikojmë, — tha Astriti — kur shikojmë në shtëpi. Ai busti në krah të djathtë të rrugës është partizani. Aty ka qenë komandatura gjermane. Rrotull bustit janë ngritur gjithë ato pallate të reja. Asnjë gjurmë nuk ka aty nga e kaluara, përveç gjurmëve të historisë së qëndrimit heroik të atij partizani të ri, që nuk tha asnjë fjalë për shokët e tij, në qelinë tërë lagështirë para xhelatëve gjermanë. Dalim tani, Genci...

— Dalim.

\*

\* \*

Ishte e treta ditë që Astriti kishte një dhembje të pashpjegueshme koke. Kishte pirë aspirina për t'u qetësuar, por dhembja e ngacmonte. Veçse kur u shkëput nga dhoma e humbi në kujtimet e atyre që lexoi për vitin 1946, para syve i doli vizioni i turbullt e i lodhur i një gruaje të vjetër të huaj. Dhembjen e kokës pothuajse e harroi. «Ja që u ngjallka edhe i vdekuri», mendoi me vete, dhe përsëri u kredh në leximin e materialeve të një dosjeje disi të vjetëruar. «Koha, mendonte, duket sikur çdo gjë e fshin, por gjurmët mbeten... Ja një e vdekur që ringjallet... Ajo është dekompozuar, por padronët duan t'u shërbejë akoma. E përse mund t'u shërbesh ti, moj e vdekur!» Astriti u ra me gisht fletëve të rreshkura nga koha. Në zyrë priste Gencin. Ai do ta



sqaronte mbi qëndrimin e turistit me emrin Hans.

— Varrin e së motrës e vizitoi. Shkoi i vetëm. Çoi dhe një buketë me lule. Aty ndejti afro tre çerek ore, pastaj u kthye në hotel, — tha Genci sapo u fut në zyrë.

— Vetëm kaq? — pyeti Astriti.

— Tani për tani, vetëm kaq.

— Kontrolluat në afërsi të varrit? — pyeti Astriti.

— Jo.

— Pse?

— S'bëri asnjë lëvizje të dyshimtë. La një buketë me lule dhe u largua.

— Të shkojmë atje. Ah, për pak harrova! Sa ditë do të rrinë turistët në qytetin tonë?

— Edhe tri ditë. Hansi dëshiron të rrijë më shumë. I lutet përkthyesit që të krijojë mundësinë e ndonjë vizite që nuk është planifikuar. «Dua të shmallem me rrugët ku ka ecur ime motër», thotë.

— Mirë — tha Astriti — derisa të errësohet, të lexojmë materialet e dosjes. Pastaj shkojmë tek varrezat.

Genci filloi të lexojë vazhdimin e dëshmisë së tradhtarit Halim S.

*«Më kujtohet mirë se si ndodhi që u takova përsëri me Marijen. Mbaj mend se ka qenë dhjetori i vitit 1944. Në prag të mbarimit të luftës u nisa për në Tiranë. Kisha frikë të rrija në qytetin tim. Në Tiranë kisha shumë nga të afërmit e mi. Ata më pritën mirë dhe më premtuan se do të më gjenin edhe punë. Lufta kishte lënë shumë të plagosur dhe nevojë për mjekë ndjehej kudo. Sidoqoftë, të afërmit më thanë që të prisja dy-tre muaj, sa të kthjellohe-*

shin mirë gjërat dhe pastaj do të më rregullonin disi. Ditën nuk dilja nga shtëpia. Kur errej, vija një kasketë në kokë (njerëzit me borsalinë qytetarët i shikonin me dyshim, pasi ata ishin kryesisht tregtarë të pasur ose intelektualë indiferentë) dhe dilja rrugicave. Në bulevardin kryesor dilja rrallë. Bunkerin në mes të sheshit kryesor të qytetit akoma nuk e kishin hequr, maja e minaresë ishte gjysmë e prishur. Rrugët ndriçoheshin pak. Le që bulevardi kishite humbur bukurinë e tij. Kudo shihje partizanë, që shetisnin me armë krahut. Para hotel «Dajtit» grupe partizanësh ia hiqnin valles. Njerëzit grumbulloheshin dhe kënaqeshin duke parë atë shkrim gëzimi kaq të çiltër, thua se ishin në ndonjë shesh fshati. Kaloja pranë tyre dhe buzëqeshja, ashtu siç bënin të tjerët. Këta, në më të shumtën e rasteve, ishin leckamanë, që kënaqeshin edhe me një këngë, ku të thirrurat në mes ishin kaq të shpeshta sa të pengonin të merrje vesh fjalët. Herëherë një mendje më thoshte që të futesha në kafe «Kursal», por trembesha. Aty mund të takoja të njohur dhe çdo gjë merrte fund. Kënaqesha me shëtitjet më gjysmë errësirë me një kasketë në kokë pa mos i folur asnjërit. Pikërisht në një nga këto shetitje, vura re një grua, që më ngjasonte me dikë. Në fillim, në mënyrë instinktive epërshëndeta dhe desha të largohem, por kur ktheva kokën vura re se edhe ajo po më shikonte. Ashtu siç isha iu afrova dhe i dhashë dorën. Gruaja në fytyrë tregonte rreth 60 vjeçe. Sytë i lëvrinin tërë gjallëri. Poshtë syve i ishin formuar dy qeska të vogla. Rrudhat në fytyrë dalloheshin qartë. Nga që ishte gjysmë errësirë, akoma nuk po e njihja, megjithëse ajo më pyeti: «Si ia çon, zoti Halim?». Unë iu përgjigja dhe prisja që ajo të



fliste prapë, të paktën ta njihja nga zëri. Por ajo s'po fliste, veç më vështronte në sy. «Ecim», më tha ajo pastaj. E vura në krah të djathtë dhe filluam të lëviznim. Ajo më futi në një rrugicë dhe nën dritën e një shtylle pyeti: «Nuk po më njeh? Kaq shpejt të zuri arterioskleroza?» Nga zëri më në fund m'u kujtua. Ajo ishte Marija. Tjetër Marije kisha njohur në vitet e luftës. Ajo, megjithëse ishte e madhe në moshë, e mbante veten, fytyrën e kishte të pastër, pa rrudha, lëvizjet e saj ishin të shkathëta. Tani, i ndodhur para një plake, as që më shkoi ndër mend se njeriu mund të shndërrohet brenda një kohe kaq të shkurtër. «Epo, gjurmët e luftës janë të dukshme», arsyetova me vete dhe i buzëqesha. Pastaj i bëra një varg me pyetje. Ajo përgjigjej shkurt. Të them të drejtën, nga biseda e parë me të, mësova vetëm se ajo ishte larguar nga qyteti ynë pak ditë para Çlirimit dhe ishte vendosur në Tiranë. Po, se ku banonte, këtë nuk e mora vesh. Pasi biseduam rreth një çerek ore, ajo më la një pikëpjekje për të nesërmen në të errur dhe u largua. Kur ngela vetëm, më pushtoi një frikë e çuditshme. Ngjeshja më fort kasketën në kokë dhe nxitova për në shtëpi të të afërmeve. Herë pas here vështroja nga mbrapa se mos më ndiqte kush. Atë natë, pasi u futa në shtëpi, nuk ndjehesha i qetë. Takimi me Marijen nuk më gëzoi aspak. Duke qenë i shtrirë në krevat m'u kujtuan takimet me Marijen gjatë luftës, kapiteni Otto, komandatura gjermane, shtëpitë përdhese, që shikonim nga kati i dytë i zyrës së Ottos, bodrumi dhe . . . fytyra e partizanit të plagosur, që më shikonte me urrejtje. Në mes të natës u ngrita. Fytyra e atij partizani më shfaqej kaq papritur sa që më tmerronte. Herë më dukej se hapej dera e dhomës dhe hynte ai, herë sikur fërshëllima e erës, që frynte për-

jashta, sillte me vete edhe fjalët e zemëruara të atij djaloshi të ri. Nuk mund të rrija shtrirë. Provova nëse e kisha mbyllur me çelës derën, kontrollova dritaren e dhomës dhe ndeza një cigare. «Eh, Marije, Marije. Ç'qe ai fat i keq që të nxori para meje!», këto fjalë i përsërita shumë herë me vete. Afër mëngjesit më zuri gjumi dhe atë ditë pothuajse e kalova në shtrat. Të afërmit u shqetësuan. Kur u err, dola nga shtëpia, vura kasketën në kokë dhe, pa vështruar anash, shkova drejt e te vendi ku do të takohesha me Marijen. Ajo ishte jetë e dytë për mua. Në duart e saj ishte ekzistenca ime. Në goftë se zbulohet ajo, atëhere edhe unë nuk do të jetoja më.

Marija nuk u vonua. Ajo, pa më takuar fare, më bëri një shenjë që ta ndiqja dhe pas një çerek ore ne ishim futur në një rrugicë të errët. Aty ajo ndaloi dhe më pyeti: «Si e ndjen veten?» «Mirë», iu përgjigja, me gjysmë zëri. «E kujton Otton?», më tha ajo pastaj. Unë në fillim heshta, pastaj thashë: «Otto! Ohu, koskat e tij kushedi ku treten, por fatit tonë si do t'i bëhet?». «Çdo gjë do të rregullohet, m'u përgjigj ajo. U takuam edhe disa herë të tjera, qanim hallet, kërkonim rrugëdalje. Një natë Marija më tha: «Tani do të futemi në një shtëpi, në fund të kësaj rrugice. Aty do të njihesh me të tjerë si ne, të cilët do të të ndihmojnë. Në bisedë me ta tregohu i kujdesshëm dhe...» Ajo nuk i mbaroi fjalët. Pranë nesh kaloi një njeri me biçikletë dhe Marija m'u afrua më pranë. «Tani nisemi», më tha ajo pasi njeriu me biçikletë u largua. Unë e ndoqa nga pas. Ajo hapi një portë të madhe prej druri, ecëm në një oborr dhe qëndruam. Dritat e shtëpisë ishin të fikura. «Ndoshta flenë», mendova. Marija iu afrua derës, trokiti tri herë dhe pritëm. Pas pak dera u hap dhe ne me shpej-



tësi u futëm brenda. Dhomat ishin të ndriçuara. Dritaret ishin të zëna me batanije të mëdha. Këto gjëra më ranë në sy menjëherë. Marija më tha që të ulesha në një kolltuk ngjyrë kafe. Unë u ula dhe ndeza një cigare. Në dhomë ngela vetëm. Marija u fut në një derë tjetër. Nga orenditë që vura re në dhomë, nga biblioteka e madhe e mbushur me libra në gjuhë të huaj, mora me mend se i zoti i saj duhej të qe një njeri jo vetëm në gjendje të mirë ekonomike, por edhe me kulturë. Në këto ambiente e ndjeja veten si në shtëpinë time. Këto më kujtonin të kaluarën, pasurinë, mirëqenien... Tek rrija në kolltuk kujtoja ditët e pazarit në qytetin tim. Ato ditë zbrisnin nga fshatrat rreth e rrotull shumë katundarë me nga një torbë krahut. Në më të shumtën e rasteve ata ishin pleq me nga një qeleshe të papastër në kokë. Si shall përdornin një peshqir të bardhë. Shpesh ata mbështillnin edhe kokën me atë peshqir. Ishin pamje që të kujtonin Turqinë... Në dhomë nuk ndejta shumë i vetëm. Marija erdhi dhe me të bisedova një copë herë. Pastaj në dhomë u fut një burrë i gjatë, me ca sy të vegjël. Flokët i kishin rënë. Në pamje të parë ai të jepte përshtypjen e një njeriu indiferent ndaj çdo gjëje. Këtë përshtypje të forconte edhe mënyra se si të pyeste:

«Domethënë ju jeni zoti Halim S, mjeku që s'bëri dot një operacion në klinikën e qytetit të tij?» pyeti pas pak burri i gjatë që quhej Abdyl. Unë qesha dhe e mora me mend se Marija do të kishte biseduar me të për shumë gjëra, derisa i kishte thënë edhe biseda të cilat ishin jashtë qëllimit që na bashkonte. Unë kështu arsyetova atëherë, por më vonë kuptova se thelbi i qëllimeve që na bashkonte me Marijen, me burrin e gjatë dhe me të tjerët, ishte

armiqësia që kishim ndaj pushtetit të ri, që doli nga lufta. Biseda jonë atë natë (dhe shumë të tjera më vonë), kishte të bënte pikërisht me organizimin e grupeve të vogla, që do t'i kundërviheshin regjimit të ri. Nga biseda e parë në atë dhomë të mobiluar bukur e me shije kuptova se e tërë kjo punë drejtohej nga të huajt, nga përfaqësuesit e fuqive të mëdha. Kjo ishte mbështetja jonë më e fortë, burimi i besimit tonë se një ditë do të fitonim. Në atë shtëpi erdha edhe ditë të tjera.

Një ditë Abdyli më caktoi me detyrë për të shkuar në qytetin tim. Atje do të takohesha me një tregtar të pasur, të cilin e njihja mirë. Në shtëpi duhej t'i shkoja natën. Veshja ime duhej të ndryshonte, në mënyrë që të mos bija në sy. Vajtja në qytetin tim ishte e rrezikshme e megjithatë unë pranova. Në valle kisha hyrë, prandaj duhej ta çoja deri në fund. Nga Tirana u nisa një mbasdreke dhe, kur ishte errur plotësisht, mbërrita në qytetin tim. Ka qenë pranvera e vitit 1945. Duke ecur me të shpejtë, shkova në lagjen ku banonte njeriu të cilin doja ta takoja. Iu afrova shtëpisë dhe tërë frikë trokita në derë. Atë e hapi vetë ai. Unë e njoha menjëherë dhe, sipas parullës që më dha Abdyli, i thashë: «Ke të fala nga Marija». Ai m'u përgjigj «Të mira e të fala paç» Unë vazhdova më tej: «Ajo kërkon pesë napolona flori», ndërsa ai m'u përgjigj: «Me gjithë hallet që kam, për Marijen do t'i gjej». Pastaj më hapi derën plotësisht dhe unë u futa brenda. Hoqa kasketën, dhe u futa në dhomë. Ai u çudit jashtë mase dhe tha: «Si, ju zoti Halim?! Unë ju dija të vrarë, e habitshme ë?!» Takimi ynë përfundoi mirë. Pasi i shpjegova qëllimin dhe i dhashë letrën e Abdylit, ai ra dakord që të bashkëpunonte



me ne. E pyeta për pasurinë e tij dhe mora vesh se lufta ia kishte shkatërruar shumicën. Organet e pushtetit të ri i bënë thirrje për të dorëzuar floririn, ndërsa ai, siç më tha vetë, një pjesë e kishte fshehur në një bodrum të thellë nën tokë. Atë natë ndejtëm deri vonë. Në mëngjes, pasi u maskova mirë, dola nëpër qytet. Më kishte marrë malli për rrugët, për vendet ku kisha kaluar aq kohë. Ecja me kujdes dhe i shmangesha vështrimit të njerëzve, shumicën e të cilëve i njihja. Por në qytet vura re edhe shumë fytyra të reja. Këta ishin ushtarakë dhe nëpunës, që kishin qejf të nxirrnin jakën e bardhë të këmishës sipër xhaketës. Në përgjithësi vija re se njerëzit kishin një si gëzim të brendshëm, pasi ecnin në një mënyrë të tillë, thua se e gjithë bota ishte e tyrja. Mua më vinte plasja kur i shihja ashtu, por isha i detyruar të heshtja, të ecja kokulur, i fshehur. Isha në të njëjtën gjendje si ajo e partizanit të plagosur, që u fut në qytet ilegalisht. Them që isha si ai vetëm për faktin që rrija i fshehur, sepse qëllimi im me idealet e partizanit ndryshonte si nata me ditën. Nga ana tjetër, dhe këtë e them tani këtu, në hetuesi, qëndrimin krenar, burrëror që ai mbajti para Ottos në qelinë e burgut unë nuk e kisha kurrë. Me këto mendime në kokë, pa dashje, këmbët më kishin çuar para ish-ndërtesës së komandaturës gjermane. Atje vura re një grumbull të madh njerëzish. Edhe të tjerë po drejtoheshin për atje. U përzjeva me turmën dhe assistova në një skenë, që nuk do ta dëshiroja kurrë. Rrethanat ishin të atilla, dhe unë qëndrova bashkë me të tjerët, kundër vullnetit tim. Të largohesha nuk bënte. Të gjithë do të më vinin re, dhe atëherë... Në një cast dikush tha që të mbahej qetësi. Një burrë rreth

30 vjeç doli para të tjerëve, në një vend pak të ngritur, dhe filloi të flasë. Nga e djathta e tij ishin një grup pionierësh. Oratori filloi të tregojë historinë e një partizani. Duke dëgjuar atë m'u kujtua partizani i plagosur, emrin e të cilit nuk e mësova kurrë. Burri 30-vjeçar pastaj tha me zë të lartë: «Ai, megjithëse ishte plagosur rëndë, qëndroi kënar para xhelatëve gjermanë, dhe jo vetëm që nuk tregoi asnjë nga shokët e tij, por akuzoi rëndë dhe goditi me fjalën e tij të zjarrtë pushtuesit gjermanë dhe bashkëpunëtorët e tyre. Atëhere bishat gjermane, pasi përdorën të gjitha mënyrat dhe nuk ia arritën qëllimit, e pushkatuan djaloshin. Në shenjë respekti ndaj atyre që ranë për lirinë e atdheut ne betohemi se veprën e tyre do ta çojmë deri në fund».

Pa e mbaruar mirë fjalën, sheshi buçiti nga një britmë e fuqishme: «Betohemi!». Ula kokën. Pastaj, grupit të pionierëve iu vu shalli i kuq në qafë. Edhe ata u betuan. Turma u shpërnda e tok me ta u largova edhe unë për të gjetur ndonjë makinë e të kthehesha në Tiranë... Në makinë më shfaqej skena e betimit të asaj turme para ndërtesës së ish-komandaturës gjermane. Pas saj më kujtohej skena e një betimi tjetër të fshehtë, në një rreth të ngushtë njerëzish. Kjo kishte ndodhur në shtëpinë e Abdylit. Përveç meje, Marijes dhe Abdylit në shtëpi ishte edhe një tjetër, emrin e të cilit nuk e mësova. Madje, përveç asaj nate, atë nuk e pashë më. Betimi ynë ishte me zë të ulët, me një nënshkrim në një letër, ku kishim hedhur parimet dhe qëllimet e organizatës sonë të fshehtë. Dhoma ishte po ajo ku hyra për herë të parë kur shkova në shtëpi të Abdylit. Dritaret ishin të zëna



me batanije. Kur udhëtoja me makinë për në Tiranë, duke krahasuar të dy betimet, më pushtonte një frikë e çuditshme. Duhet t'ju them se frika nuk më është ndarë gjatë gjithë kohës që u kam shërbyer, qoftë gjermanëve, qoftë anglo-amerikanëve. Kur u ktheva në Tiranë, mora vesh se Marija ishte caktuar për të shkuar prapë në qytetin tim. Arsyeja unë nuk e mora vesh qysh në fillim. Pas disa muajsh Abdylit ma sqaroi. «Ajo është e huaj, — më tha. — Nuk shihet me sy të mirë. Ndoshta është elementi i vetëm i organizatës që mund të na komprometojë në sy të SEMP-it. Atje është lajmëruar personi që takove ti, për ta qëruar.» U trondita shumë kur dëgjova këto fjalë. Abdylit më hodhi dorën në sup dhe më tha: «Këtë gjë e bëjmë me porosi të atyre». Ndonëse nuk përmendi emra, e kuptova se bëhej fjalë për anglo-amerikanët dhe heshta. «Pastaj, — nisi të flasë Abdylit, — bota u përket të guximshëmve. Këtë nuk e them unë, por Napoleoni i madh, i dashur. Prandaj guxim!» Kur dola nga shtëpia e Abdylit vura re përsëri një njeri me biçikletë që kaloi pranë meje. Nxitova hapat për në shtëpi të të afërmve, të cilët më kishin lajmëruar se së shpejti do të filloja punën. Tani që isha anëtar i organizatës së fshehtë nuk e ndjeja më nevojën për lekë. Pas shumë ditësh Abdylit më tha se Marija kishte vdekur dhe qeshi nën buzë.

Dy ditë më vonë mua më arrestuan dhe... Por dua të them edhe diçka në lidhje me Abdylin. Ai...»

Genci ndërpreu leximin. Astriti pa orën.

— E lëmë vazhdimin për nesër, — tha Astriti.

— Si të duash, — iu përgjigj Genci.

— Mund të vazhdonim edhe sonte, por po fillon të erret dhe na duhet të kontrollojmë në varreza.

— Mirë, — iu përgjigj Genci, — shkojmë!

Kur arritën në periferi të qytetit ishte errur. Varrezat ishin pak më tej, në një kodrinë të vogël e të bukur. Roja plak i njohu dy punonjësit e Sigurimit. Një herë mendoi të mos u fliste, por kur Astriti ia bëri me shenjë, ai u afrua pranë tyre.

— Si u ngryse, xha Adem? — Astriti i zgjati dorën xha Ademit, pastaj iu drejtua Gencit: — Ti Genci merr edhe xha Ademin dhe delni shetitni andej tutje, — dhe, pasi u tregoi nga të shkonin, shtoi: — Unë do të kthehem shpejt.

Ndërsa xha Ademi dhe Genci ia nisën bisedës duke shetituar, Astriti shkoi te varri i gruas së Jozefit. Në krye, afër kryqit, ishte vendosur një buketë me lule të freskëta. «Lulet e të vëllait», tha me vete Astriti. U ul dhe filloi të shikojë me kujdes. Rrotull varrit nuk kishte asgjë. Mbrëmja kishte rënë, e hëna kish nxjerrë syrin në qafën e malit. që ishte kundruell qytetit. Kontrolli natën në varre Astritit i ngjalli një ndjenjë jo të këndshme. Dëgjohej vetëm kënga e bulktheve. Genci me rojen plak vazhdonin bisedën... Astriti ngriti buketën me lule, lëvizi një pllakë, ku ishte mbërthyer fotografia e një gruaje, dhe shtangu. Në një



si gropëz ishte vendosur një copë letër. Nuk e lëvizi nga vendi. E pa pozicionin mirë e mirë, pastaj me kujdes e mori letrën në dorë. E hapi me kujdes. Në gjuhën engleze ishin shkruajtur fjalët: «Për çdo gjë drejtohuni tek «Plaku» në lagjen... rruga... nr. 13. Parulla do të jetë: «Jozefi nuk jeton më?» Ai do t'ju përgjigjet: «Jo, bile edhe gruaja i vdiq». Ju do t'i thoni: «Me keqardhje». Ai pastaj do të dijë si të veprojë. Këtë do ta bëni pesë ditë pasi të iki unë. Nesër pres njoftimet e premtuara.

*Bruti».*

Letrën e mbështolli me kujdes. E vuri prapë në vend dhe pllakën ku ishte ngjitur fotografia e vendosi në pozicionin e parë. Pastaj u drejtua nga dera e varrezave, ku e prisnin Genci me xha Ademin...

Të nesërmen Hansi ndjehej i gëzuar. Doli nga dhoma e tij, zbriti në katin e parë dhe hyri në restorant. Tryezat pothuajse ishin plot dhe ai u ul afër përkthyesit.

— Perëndimet janë shumë të bukura, — tha Hansi.

— Mëngjeset me lindjet e diellit janë akoma më të bukura, — shtoi përkthyesi.

— Kam një dëshirë. Sot do të shkoj përsëri në varrin e motrës dhe dua të më shoqëroni ju, — i tha Hansi dhe ia nguli sytë Jorgos. Ky, për herë të parë gjatë gjithë atyre ditëve, dalloj në sytë e Hansit një vështrim të ftohtë.

— Në qoftë se jam i lirë, ju shoqëroj me gjithë qejf, — u përgjigj Jorgoja.

— Do ta gjejmë kohën e lirë. Pas dreke, kur të flenë të tjerët, ne shkojmë atje. Dakord? — Hansi iu afrua Jorgos dhe gati sa nuk e ciku në fytyrë.

— Dakord! — u përgjigj Jorgoja.

Në ora 2 e 30 minuta në varrezat në periferi të qytetit, midis zhegut të vapës, Hansi me Jorgon vështronin varret. Hansi vuri një buketë tjetër në varrin e së motrës.

— Jorgo, — tha ai pastaj, — këto janë varre të ushtarëve dhe oficerëve tanë të rënë në luftë. Midis tyre ka edhe me emrin Hans. Kontrolloji dhe me siguri do të të dalin mbi dhjetë Hansa. Shikoji, të lutem, shikoji.

Jorgoja filloi të lexojë emrat sipër varreve. Hansi u ul, lëvizi pllakën me fotografinë e së motrës dhe nxori që andej një copë letër. Pastaj futi aty një tjetër, e mbuloi përsëri dhe u ngrit në këmbë. Hodhi sytë nga Jorgoja. Ai vazhdonte të lexonte emrat.

— Hans, deri tani shtatë. Do të gjej të tjerë.

— Vazhdo, vazhdo, unë po pi një cigare.

Hansit nuk i durohej sa të lexonte atë letër.

Për t'u siguruar vështroi edhe një herë rreth e rrotull. Asgjë s'pipëtinte. Vetëm Jorgoja lexonte emrat sipër pllakave. Me duart që i dridheshin, e hapi copën e vogël të letrës dhe në gjuhën e tij amtare, në një shkrim të bukur e të pastër, lexoi: «Letrën tuaj e morëm. Të falenderojmë. Vend më të përshtatshëm nuk kishe si gjeje tjetër. Siç du-



ket nuk do t'i mundosh të afërmit. Vjen vetë e fute në varr...»

Letra i ra nga duart, u zverdh, dhe nuk dinte ç'të bënte. Në ballë i dolën bulëza djerse. «Fundim, midis varreve të bashkatdhetarëve të mi? E tmerrshme». Në këtë kohë Jorgoja bërtiti nga larg:

— Hans, u bënë tetë, tetë...

Papritur nga një vend aty afër dualën, Astriti, Genci dhe dikush tjetër.

— Nëntë, është më mirë të thuash, nëntë, — tha Astriti.

Pasi mbaruan formalitetet e rastit, Hansi e pa veten në një zyrë, ulur në tavolinë përballë hetuesit, dhe me zërin që i dridhej pohoi:

— Unë nuk jam vëllai i asaj gruaje. Ajo ka qenë një agjente e vjetër. Qendra e urdhëroi atëhere që të mos kthehej. Më vonë ajo u bë agjente e italianëve, pastaj e gjermanëve dhe aty nga viti 1945 e amerikanëve. E mbante në lidhje, bashkë me disa të tjerë, një anëtar i misionit ushtarak amerikan të akredituar në Tiranë. Në vitin 1946 ajo vdiq aksidentalisht. Shumë nga pjesëtarët e organizatës së saj u arratisën. Disa prej tyre dolën para gjyqit. Të tjerë ngelën këtu... Me njërin prej tyre duhej të takohesha sot.

— Me atë, adresën e të cilit kishit shënuar në këtë copë letër? — e ndërpreu hetuesi.

— Po, pikërisht me atë. Vendin e takimit ai e dinte.

— Tek varri i gruas së Jozefit, apo jo?

Mos doni të takoheni me «Plakun» dhe të tjerët? — pyeti hetuesi.

Hansi mundi të bëlbëzojë:

— Ju lutem shumë, jo. Nuk dua më, nuk dua të tronditem. Më lini të lirë, të iki, të iki sa më parë në vendin tim.

— Tani dilni përjashta. Do të vazhdojmë prapë bisedën...

Hetuesi ngeli vetëm në zyrë. Astriti, që hyri pothuaj pa u kuptuar, e gjeti tek vështronte nga dritarja.

— Ç'thotë Hansi? — pyeti Astriti. Hetuesi u kthye rrëmbimthi dhe tha:

— Nuk ka se nga t'ia mbajë. Provat janë të plota dhe të sakta.

Astriti tha:

— Nga leximi i materialeve të dosjes mbi aktivitetin armiqësor të grupit të gruas së Jozefit pas Çlirimit, konstatova një veprim shumë të zgjuar, që është baza e suksesit tonë të tanishëm. Pasi vdiq gruaja e Jozefit, grupi operativ e mbajti në heshtje veprimtarinë e saj. Nuk u bë fjalë fare për të. Shokët atëhere menduan se në grupin e saj do të kishte edhe të tjerë, përveç Halimit. Emri i Marijes nuk u përmend. Kjo gjë e vuri në gjumë zbulimin e huaj. Pas kaq vjetësh ata, duke menduar se ndaj gruas së huaj nuk ka pasur kurrfarë dyshimi nga sigurimi shqiptar, nisën Hansin për të marrë në lidhje një pjesë të grupit të saj. Edhe këta, me në krye «Plakun», u vunë në gjumë dhe tani menduan të riaktivizohen. Me kapjen e Hansit, u vërtetuan plotësisht dyshimet e grupit operativ të vitit 1946.



Hetuesi bëri një pyetje:

— Kush e kryesonte atëhere grupin dhe ku është ai tani?

— Me këtë veprim merrej shoku Jani. Tani ai është në pension. Ne u konsultuam me të para se të fillonim veprimet. Tani do t'i bëjmë një vizitë bashkë me Gencin. Po të doni hajdeni dhe ju.

— Do të vij, — tha hetuesi.

— Shkojmë — tha Astriti. — Jashtë na pret Genci. — Ata dolën në rrugë. Dielli ndriste në kupë të qiellit.

## PËRMBAJTJA

	Faqe
1. I panjohuri i Rinasit .....	3
2. Krisma nëpër natë .....	35
3. Atë ditë që bëhej betimi .....	47
4. Shtegtimi i fundit .....	56
5. Tek varri i gruas së Jozefit .....	82



---

Tirazi: 8000 kopje

Format 70 x 100/32

Stash: 2204-72

---

Shtypur: Drejtoria Qendrore e Poligrafisë  
Shtypshkronja «MIHAL DURI» — Tiranë, 1975